

HAVARIXHËT



ALI NASIR FEKIHI

Havarixhët

“Përhapja në internet e kerameteve të muxhahidinëve: Një nga rrugët që përdorin Havarixhët për të ndezur emocionet e rinisë.”

Autor:

Shejkh ‘Ali Nasir el-Fakijhi

Autor:

Shejkh 'Ali Nasir el-Fakijhi

Titulli i librit:

Havarixhët

Përktheu:

Jeton Shasivari

Alban Malaj

Altin Dallashi

Botim Privat

Përmbajtja

Rreth autorit.....	4
A konsiderohen Havarixhë ata të cilët kryejnë atentate e shpërthime në emër të Xhihadit?	5
Menhexhi i Ehli-Sunetit në trajtimin e Havarixhëve.....	6
Ngjashmëria në mes Havarixhëve dhe Rafidijvr.....	10
Havarixhët dhe ata që i mbrojnë ata.	11
Jehudët dhe të Krishterët nuk janë armiq të Rafidijve dhe Havarixhëve, por të gjithë këta janë mbledhur kundër Ehli Sunetit.	13
Dialog në mes Shejkhut dhe Kharixhiut Terrorist.	16
Historitë më të çuditshme të Havarixhëve në kohët e lashta dhe në kohën tonë.....	24
Grupi “Shteti Islamik i Irakut dhe Shamit” është një organizatë terroriste.	27
Grupi “SHIISH” nga ana e jashtme duken sikur e ndihmojnë Islamin por në realitet u shërbejnë armiqve të Islamit.....	29
A ka xhihad në Siri dhe si është puna e grupeve që luftojnë atje, si SHIISH, etj?	31
Realiteti i Xhebbetu-Nusra dhe SHIISH që luftojnë në Siri.	42
Një i ri shkoi të luftojë në Siri kundër Besharit, por atje pa se Muslimanët vrasin njëri-tjetrin.....	48
Havarixhët dhe veprat e tyre të pështira që i bëjnë në Siri dhe Irak.	50
Dallimet thelbësore mes ISIS dhe Selefizmit.....	55

Rreth autorit

Shejkh ‘Ali Nasir el-Fakijhi, një nga Dijetarët e shquar të Medines, ka shpjeguar se ajo që thuhet rreth këtyre kerameteve (mrekullive) është një nga rrugët e Havarixhëve të cilët i përdorin ato për të ndezur emocionet e rinisë. Ai ka thënë:

“Vërtet, ideologjia e Havarixhëve e cila konsiston në shpalljen e shoqërive Islame si shoqëri të kufrit nuk ka pushuar së ekzistuari. Dhe kjo ideologji ka thirrësat dhe organizatorët e saj që merren me përhapjen e saj. Ajo është përhapur duke përdorur këto mjete, me anë të përdorimit të Internetit dhe thirrësat (e kësaj ideologjie) i përhapin ato mes të rinjve për të ndezur emocionet e tyre fetare. Kjo bëhet duke përhapur ato që sipas pretendimit të tyre janë mrekulli (keramete) të muxhahidinëve dhe kjo është nga rrugët e ndezjes së tyre emocionalisht dhe shfrytëzimit të entuziazmit të tyre. Prandaj ata u qasen atyre nga rruga e Fesë së tyre.

Dhe ka ardhur në hadithin e Ebu Bekrit për një hadith të ‘Ali Ibn Ebi Talib (radij-Allahu ‘anhu) ku përshkruhen Havarixhët - dhe Ibn Haxheri e ka përmendur atë në shpjegimin e hadithit: “Pastaj Shejtani do të vijë tek ata nga rruga Fesë së tyre.” Dhe kjo po ndodh sot sepse ato që po përhapen në Internet burojnë nga njerëz të paidentifikuar, të cilëve nuk u njihet as dija dhe as feja e tyre. Dhe e gjithë kjo bëhet për të ndezur emocionet e të rinjve për fenë e tyre. Këto gjëra nuk u kanë hije personit inteligjent sepse ai shndërrohet kështu në një injorant të paidentifikuar (**në Internet**) dhe një person i tillë mund të jetë agjent i futur sipas koordinimeve të caktuara nga njerëz që kanë qëllime armiqësore ndaj Islamit, qëllime të cilat nuk u tregohen haptazi njerëzve. Dhe kur ne i lajmërojmë njerëzit për këto çështje, ne nuk i refuzojmë kerametet (**mrekullitë**) e Eulijave (**njerëzve të**

devotshëm e të afërt të Allahut). Përkundrazi, këto çështje janë të vërteta dhe ato janë prej Akijdes së Ehli-Sunetit dhe Xhematit. Gjithashtu, ne nuk e mohojmë atë që po heq Islami dhe Muslimanët nga armiqtë e tyre. Këto çështje dihen mjaft mirë dhe është obligim për çdo Musliman që të bëjë atë që ka mundësi lidhur me këtë. **“Sidoqoftë, Xhihadi në rrugë të Allahut ka kushte dhe rregulla dhe janë Dijetarët dhe Juristët e Fesë (Dijetarët e Fik’hut) ata të cilët i shpjegojnë të gjitha këto.”**

A konsiderohen Havarixhë ata të cilët kryejnë atentate e shpërthime në emër të Xhihadit?

Shejkh Salih el-Feuzan (Allahu e ruajt)

Pyetje: “Pyetësi pyet për këtë grup që i kanë lënë Muslimanët dhe po i kundërshtojnë ata. Ata kryejnë shpërthime me bomba dhe i terrorizojnë njerëzit të cilët më përpara kanë qenë të qetë. A janë me të vërtetë këta njerëz prej Khaurixhëve apo janë Qafira?”

Përgjigje: “Ky grup i cili i ka lënë Muslimanët dhe është rebeluar kundër tyre - kjo ka ardhur si rezultat i braktisjes së Dijetarëve. Unë i përmenda pasojat e kësaj gjatë pjesës së fundit të ligjëratës **(së mëparëshme)**. Ata u larguan nga Dijetarët, u larguan nga Prijësat e Muslimanëve dhe kështu kufarët me munafikët ua futën në mendje këtë ideologji. Në këtë mënyrë ata dolën fare nga shoqëritë e Muslimanëve.

Ata janë Havarixhë, nuk ka asnjë dyshim! Veprimet e tyre janë veprime të Havarixhëve. Madje, ata janë më të dhunshëm dhe më

ekstremistë sesa Havarixhët (**e hershëm**). Havarixhët nuk i shkatërronin ndërtesat dhe vendbanimet. Havarixhët dilnin ballëpërballë në betejë. Ata luftonin në shesh të betejës megjithëse ishin injorantë. Por ata nuk i rrënonin shtëpitë me gjithë njerëzit që ishin brenda tyre: gra, fëmijë, të pafajshëm, njerëz të cilët ishin në paqe me Muslimanët, ata të cilët kishin marrëveshje me Muslimanët dhe ata njerëz të cilëve u ishte garantuar siguria. Havarixhët nuk e bënë këtë. Kjo është akoma më e keqe dhe më mizore sesa veprimet e Havarixhëve. Kjo ngjan më shumë me veprimet e Keramitëve. Ata ngjajnë më shumë me Keramitët sepse veprimet e Keramitëve janë të fshehta e tinëzake, të bazuara në sekrete dhe njësoj, ajo çfarë bëjnë këta njerëz sot është e bazuar mbi sekrete. **“Veprimet që ndërmerrnin Havarixhët nuk ishin të fshehta e sekrete; ata i nxirrnin në shesh vetet dhe veprimet e tyre duke i deklaruar ato. Kështu që, këta njerëz janë më të këqinj sesa Havarixhët.”**

Menhexhi i Ehli-Sunetit në trajtimin e Havarixhëve.

Autor: **Shejkh Salih el-Feuzan** (Allahu e ruajt)

Burimi: ‘Ittihaful-Karij bit-Ta’likat ‘ala Sherhus-Sunneh lil-Imam Berbahari’ (fq. 240-242, vëllimi 1)

Imam Berbahari (rahimehullah) ka thënë në Sherhus-Sunneh:

“Lejohet që t’i luftosh Havarixhët nëse ata sulmojnë pasuritë e Muslimanëve ose Muslimanët me familjet e tyre, por nëse ata janë të shpërndarë, atëherë Prijësi Musliman nuk duhet t’i kërkojë, as nuk duhet t’i vrasë të plagosurit e tyre, as nuk duhet të marrë plaçkë lufte nga ata, as nuk duhet t’i vrasë ata që janë zënë robër dhe as nuk

duhet t'i ndjekë nga pas ata që kanë shpëtuar.”

Shejkh Salih el-Feuzan e komentoj thënien e mësipërme të Imam Berbaharit (rahimehullah) duke thënë:

“Ne dimë që Havarixhët janë ata të cilët mendojnë se mund të heqin dorë nga bindja **(ndaj prijësit)**. Ata mendojnë se prijësit nuk i jepet besa e aleancës ose që njerëzit nuk e kanë detyrë që ta mbajnë besën e tyre për aleancë me të **(me prijësin)** kur ai bie në gjynahe, dhe ata **(gjithashtu)** i shpallin Muslimanët qafira për gjynahet e mëdha që bëjnë.

Kështu, nëse ata marrin këtë medh’heb **(të mendimeve që sapo u përmendën)** dhe nuk ndodh asnjë trazirë apo vrasje **(nga ana e tyre)**, atëherë ata lihen, këshillohen dhe sqarohen me shpresën se do të pendohen. Nëse ata shkaktojnë trazira dhe tregojnë forcën e tyre, atëherë bëhet obligim për Muslimanët që t'i luftojnë ata për të larguar të keqen e tyre.

Ata nuk duhet të luftohen në bazë të parimit që ata janë mosbesimtarë, por ata duhet të luftohen në bazë të parimit që ata janë Muslimanë të cilët bëjnë shkelje dhe dhunë kundër Muslimanëve. Prandaj kur u pyet Prijësi i Besimtarëve, ‘Aliu (radij-Allahu ‘anhu) për Havarixhët, **“A janë ata mosbesimtarë?”** ai tha: **“Jo, ata e kanë braktisur mosbesimin, por janë njerëz që u rebeluan kundër nesh.”**

Kështu që, ata nuk duhet të luftohen me parimin që ata janë mosbesimtarë, dhe kjo është arsyeja përse gratë dhe fëmijët e tyre nuk merren si robët, as pasuritë e tyre dhe as të plagosurit e tyre nuk

vriten, pasi ata luftohen vetëm për të larguar të keqen e tyre dhe për shkak të kufrit (**mosbesimit**).

Dhe për sa i përket thënies së Imam Berbaharit (rahimehullah):

“Lejohet që t’i luftosh Havarixhët nëse ata sulmojnë pasuritë e Muslimanëve ose Muslimanët me familjet e tyre” sepse Pejgamberi (sal- lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) urdhëroi që ata të luftohen, dhe sepse ‘Aliu (radij- Allahu ‘anhu) “i luftoi ata kur ata sulmuan dhe vranë ‘Abdullah Ibn Khabbab el-Arrat dhe i çanë barkun gruas së tij e cila ishte shtatzënë.” [1] Kështu, Prijësi i Besimtarëve, ‘Aliu (radij-Allahu ‘anhu) vendosi t’i luftojë ata pasi ata sollën një arsye të fortë për t’u luftuar.

Për sa i përket thënies së Imam Berbaharit (rahimehullah): “Por nëse ata janë të shpërndarë, atëherë Prijësi Musliman nuk duhet t’i kërkojë.”

Nëse ata e ndërpresin luftimin, prijësi nuk duhet t’i ndjekë ata nga pas dhe as nuk duhet të dërgojë ekspeditë ushtarake kundër tyre, për sa kohë që ata nuk kryejnë akte dhune. Dhe nuk ka dyshim që ata janë të devijuar dhe duhet të këshillohen me shpresën se mund të kthehen (**duke u penduar**) dhe nuk duhet të luftohen.

Për sa i përket thënies së Imam Berbaharit (rahimehullah): **“As nuk duhet t’i vrasë të plagosurit e tyre”**; sepse e keqja e personit të plagosur është zvogëluar.

Për sa i përket thënies së Imam Berbaharit (rahimehullah): **“As nuk duhet të marrë plaçkë lufte nga ata”**; që do të thotë se pasuria e tyre nuk duhet marrë si plaçke lufte, pasi ajo është pasuria e Muslimanëve.

Për sa i përket thënies së Imam Berbaharit (rahimehullah): **“As**

nuk duhet t'i vrasë ata që janë zënë robër"; ngaqë ata janë Muslimanë, dhe duke qenë të plagosur dhe të zënë robër, e keqja e tyre është zvogëluar.

Dhe për sa i përket thënies së Imam Berbaharit (rahimehullah): **"As nuk duhet t'i ndjekë nga pas ata që kanë shpëtuar"**; nëse ata shpëtojnë duke ia mbathur, prijësi duhet t'i lërë dhe të mos i ndjekë nga pas sepse e keqja e tyre është zvogëluar."

Fundnotë:

[1] **Sh.p:** Shejkh 'Abdul-Muhsin el-'Ubejkan e përmend këtë ngjarje në librin e tij 'el-Havarixh uel-Fikral-Mutexhedid', i cili thotë: **"Ajo që vërteton injorancën e tyre është ngjarja që ndodhi gjatë kohës së 'Aliut (radij- Allahu 'anhu). Ai u çua e mbajti hytbe dhe i nxiti ata që të bënin Xhihad dhe të kishin durim kur të ndesheshin. Dhe ai e mori vendimin për të sulmuar njerëzit e Shamit kur atij i erdhi lajmi se Havarixhët po bënin shkatërrim në tokë, po derdhnin gjak, po grabisnin dhe po merrnin atë që nuk ishte e ndaluar. Një prej atyre që vranë ata ishte 'Abdullah Ibn Khabbab (radij-Allahu 'anhu), një Sahab i të Dërguarit të Allahut (sal- lAllahu 'alejhi ue sel-lem). Ata e morën atë si rob bashkë me gruan e tij shtatzënë. Ata i thanë: "Kush je ti?" Ai tha: "Unë jam 'Abdullah Ibn Khabbab, Shok i të Dërguarit të Allahut (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) dhe ju më trembët."** Ata i thanë: **"Asgjë nuk ka për të ndodhur ty. Na trego çfarë ke dëgjuar nga babai yt."** Dhe ai tha: **"E kam dëgjuar babain tim duke thënë: E kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) duke thënë: "Ka për të ndodhur një fitne. Ai që është i ulur në atë kohë do të jetë më mirë se ai që është në**

këmbë. Ai që është në këmbë do të jetë më mirë se ai që po ecën. Dhe ai që po ecën do të jetë më mirë se ai që po vrapon.” Atëherë ata e kapën atë nga dora. Dhe kur po ai po ecte bashkë me ata, disave prej tyre u doli përpara një derr që e zotëronte një jo-Musliman që paguante taksën e sigurisë në tokën Islame (**Dhimmi**). Njëri prej tyre e qëlloi derrin me shpatën e tij dhe i rropi lëkurën. Kurse një tjetër i tha: **“Përse e bëre këtë kur ai (derri) i përket një dhimiu?”** Kështu, ai shkoi tek dhimiu dhe u soll me përzemërsi dhe i bëri qejfin atij! Gjithashtu, kur ai (‘Abdullah Ibn Khabbabi) ishte me ta, një hurmë ra nga palma dhe njëri prej tyre e mori dhe e futi në gojë. Kurse një tjetër prej tyre i tha atij: **“Ti e more këtë pa marrë leje apo pa dhënë ndonjë çmim për të?”** Kështu, ai e hoqi nga goja. Gjithsesi, ata erdhën tek ‘Abdullah Ibn Khabbabi dhe e therën atë. Pastaj erdhën tek gruaja e tij dhe ajo u tha: **“Unë jam një grua shtatzënë, a nuk po i frikësoheni Allahut ‘Azze ue Xhel?”** Dhe kështu, ata e therën edhe atë, i çanë barkun dhe ia shqyen fëmijën e sapoformuar në embrion.”

Shikoni pra se si ata përmbahen nga diçka që ishte e lehtë, por ata nuk përmbahen nga derdhja e gjakut, shenjtëria e të cilit është shumë e madhe. Ata u përmbajtën nga vrasja e atij derri për shkak se ai i përkiste një qafiri dhimmij! Dhe ata shkuan tek ai dhe ta merrnin me të mirë. **“Në të njëjtën kohë, ata u përmbajtën nga ngrënia e një hurme që ra nga palma. Por gjithsesi, ata nuk u përmbajtën nga vrasja e një Muslimani!”**

Ngjashmëria në mes Havarixhëve dhe Rafidijvr.

Shejkh Muhamed bin Abdul-Uehhab el-Akil (Allahu e ruajtë)

Rafidijtë në realitet janë Havarixh në çdo kohë, ata janë Havarixh. Si qenkan rafidijt Havarixh?! Po. Sepse ai që e ka themeluar medh'hebin e rafidijve dhe ai që e ka themeluar medh'hebin e Havarixhëve është një – çifuti Abdullah bin Sebe – ky është ai që e themeloi medh'hebin e rafidijve dhe medh'hebin e Havarixhëve, porse ai kishte dy programe të gatshme: një program **(Windows) XP** që ua dha rafidijve dhe ata u bënë rafidij dhe një program **(Windows) Vista** që ua dha Havarixhëve dhe ata u bënë Havarixh. Dy programe të gatshme. Të dyja – Allahu të ruajtë – janë nga Microsofti. **(Havarixhët dhe rafidjt)** të dy janë nga Abdullah bin Sebe, kështu, Allahu ju ruajtë. Betohem në Allahun.

Dhe për këtë arsye ka një lidhje tejet të fortë në mes Havarixhëve dhe rafidijve në bërjen tekfir mbi muslimanët. Havarixhët bëjnë tekfir mbi muslimanët dhe Ehlu Sunetin.

Havarixhët dhe ata që i mbrojnë ata.

Autor: Shejkh Salih es-Suhejmi

Sa të shumtë janë qentë e zjarrit të cilët bëjnë shpërthime në vendet Islame dhe në kështjellën e Islamit , pasi që ata i kanë mobilizuar endacakët, nxënësit e Jehudëve dhe të Krishterëve, bishtat e Masonëve dhe Klubit Rotarian.

Shërbëtorët e Jehudëve, të Perëndimit dhe të Lindjes, japin fetva nga shpellat e maleve të qafirëve si dhe nga vendet e Perëndimit të cilët i kanë marrë përsipër që t'i mbrojnë ata (khaurixhët) dhe u dalin në ndihmë atyre.

Mjerë këta fortesa që e prodhojnë këtë helm vdekjeprurës dhe kjo është ndihmesë për armiq të Islamit kundrejt Islamit dhe

muslimanëve.

Allahu i vraftë ata që i financojnë. Allahu i vraftë ata që heshtin ndaj tyre.

Allahu i vraftë ata që bashkëpunojnë me ata.

Allahu i vraftë ata që solidarizohen me ata. Allahu i vraftë ata që i justifikojnë ata.

Allahu i vraftë ata që e justifikojnë veprën e tyre.

Allahu i vraftë ata që mendojnë se ata janë në rrugën e drejtë.

Allahu i vraftë ata që heshtin ndaj tyre qoftë edhe me një heshtje të vetme.

Allahu i Lartësuar thotë:

“Mos e fshihni dëshminë, se, kush e fsheh atë, zemra e tij është gjynahqare.” El-Bekare, 283

I Dërguari – sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem – thotë:

“Ai që e fsheh dijen, Allahu do t’i vendosë një frerë prej frerëve të zjarrit Ditën e Gjykimit.”

Ngase ata janë nga krijesat dhe njerëzit më të këqij.

Kush është ai që e ka thënë këtë? Kush është ai që i ka përshkruar ata se janë krijesat dhe njerëzit më të këqij? I Dërguari – sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem – .

Kush është ai që i përshkruar se ata janë qentë e zjarrit? I Dërguari – sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem – .

Kush është ai që i ka përshkruar ata se do të dalin nga feja ashtu siç

del shigjeta prej gjahut, e lexojnë Kuranin, por ai nuk e kalon gurmazin e tyre? Ai është i Dërguari – sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem – .

Kush është ai që i ka përshkruar ata se do t’i vrasin muslimanët dhe do t’i lënë të lirë idhujtarët? Ai është Pejgamberi – sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem – .

Kush është ai që ka thënë për ta: “Të vrarët më të këqij janë të vrarët e tyre, dhe ata janë të vrarët më të këqij nën këtë qiell, dhe i vrari më i mirë është ai që e vrasin ata?” Ai është Pejgamberi – sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem – .

Sa të shumtë janë në këtë kohë, Allahu mos i shtoftë kurrë. Madje ata bëjnë më shumë krime se Havarixhët e vjetër, ngase Havarixhët e vjetër bënë adhurim, kishin frikë Allahun, kishin asketizëm dhe besnikëri. Kurse këta gënjeshtar endacak e kanë **(parimin): “Qëllimi justifikon mjetin.”**

Jehudët dhe të Krishterët nuk janë armiq të Rafidijve dhe Havarixhëve, por të gjithë këta janë mbledhur kundër Ehli Sunnetit.

Autor: Shejkh Salih es-Suhejmi

Burimi: Shpjegim i “Usulu Sunneh”, të Imam Ahmedit, ligjërata e 10, më datë 13 Ramadam 1435 në Xhamin e Pejgamberit, kapitulli “El-Imanu bi- Adhabil-Kabr,” min. 32:20

O vëllezërit e mi! Mos harroni të bëni lutje për vëllezërit tuaj në Palestinë, në Siri, në Irak dhe në çdo vend tjetër, meqë këto janë komplete të njohura për të cilat kanë bërë marrëveshje të gjithë qafirat, siç janë: Jehudët, të Krishterët, Hizbu-Iblis **(hizbullah)**,

Rafidjitë si dhe të tjerë. Janë bërë bashkë për t'i thurur këto komplote që t'i largojnë muslimanët nga Teuhidi dhe t'i sprovajnë ata, me qëllim që t'i realizojnë interesat e tyre, e që është çrrënjësja e muslimanëve Ehli Sunneh.

Porse ata do të zbrapsen me shkatërrim - me lejen e Allahut –. Qofshin Jehudët, të Krishterët, Perëndimi dhe Lindja, apo Hizbu-Iblis, apo Rafidijtë apo ata që bëjnë koalicione të fshehta kundër Ehli Sunnetit, apo Havarixhët dhe të tjerë. Të gjithë këta do të mbarojnë – me lejen e Allahut –.

“Çdo herë që shfaqet një grup prej tyre (Havarixhëve), ata do të vriten.”

Allahu do t'i vrasë grupet e tyre. Por, kjo çështje kërkon tre gjëra:

Gjëja e parë: Kthimi tek Allahu – i Madhëruar e i Lartësuar –. Të përmirësohet ajo që është në mes nesh dhe Zotit tonë. Largimi nga mëkatet.

Gjëja e dytë: Mbështetja tek Allahu dhe besimi tek Ai.

Njëri po bërtiste dje në Gaza dhe thoshte: **“O Salahuddin!” Mu kjo është Shirk.** Si po çirresh dhe thua: O Salahuddin! Salahuddini ka vdekur – Allahu e mëshiroftë –, ne bëjmë lutje për të, Allahu ia shpërbleftë për atë që ka bërë për Islamin dhe Muslimanët. Porse ne nuk e thërrasim atë **(për ndihmë): Mos thuaj: O Salahuddin!** Mos thuaj: **O M’utesim! Mu kjo është Shirk.** Si shpreson shpëtim kur ti i lutesh dikujt tjetër pos Allahut?! Lute Zotin tënd.

Thuaj: O Allah! O i Gjallë, o i Përjetshëm! O Poseduesi i Madhështisë dhe Krenarisë!

Mos thuaj: O M’utesim! Mos thuaj: O Salahuddin! Mos thuaj: O i

Dërguari i Allahut, sepse ai që kërkon ndihmë nga i Dërguari i Allahut, ka bërë Shirk.

Thuaj: O Zoti im! O Poseduesi i Madhështisë dhe Krenarisë! O i Gjallë, o i Përjetshëm!

O Allahu im! Shkatërroi ata dhe vriti ata duke qenë të përçarë dhe mos lër asnjë prej tyre. Qofshin shejtanët e Havarixhëve dhe SHIISH-it, apo shejtanët e Jehudëve dhe të Krishterëve në Lindje dhe Perëndim, apo shejtanët e Rafidijve dhe Hizbu-Iblisit.

O Allahu im shfarosi ata, vrite edhe të fundin e tyre. Na ndihmo neve kundër tyre. Dënoi ata ashtu siç dënon Ti i Plotfuqishëm dhe Plotpushtetshëm. Na i trego tek ata, çudirat e Plotfuqisë Tënde (duke i dënuar ata, sh.p).

O Allahu im! Triumfuesi mbi të gjitha grupet dhe Krijuesi i reve. Dënoi ata ashtu siç dënon i Plotfuqishmi dhe Plotpushtetshmi. O Allahu im mos lër asnjë prej tyre në tokë.

O Allahu im shfarosi ata. O Allahu im zbrite Fuqinë tënde mbi ta, nga e cila nuk mbrohen dot populli zullumqar.

Janë mbledhur që të gjithë: Rafidijt, Havarixhët, Jehudët, të Krishterët si dhe qafirat tjerë që janë me ta, o Allahu im shkatërroi ata, sepse nuk të shpëtojnë dot Ty.

O Allah im! Ata janë mbledhur në batil (të kotën). Ata bëjnë koalicione të fshehta, nga ana tjetër (publikisht) shfaqin armiqësi për njëri-tjetrin, porse ata gënjejnë!

Pasha Allahun gënjejnë Pasha Allahun, Jehudët, të Krishterët, Perëndimi dhe Lindja nuk janë armiq të Rafidijve, nuk janë armiq të

Havarixhëve.

Janë po ata që i kanë sjellë, janë ata që i kanë armatosur, janë ata që u kanë shitur armë, ngase synimi i tyre me të cilin gjuajnë është shfarosja e Ehli

Sunnetit, Ehli Sunnetit dhe Xhematit, porse ata do zmbarsen me shkatërrim, disfatë dhe poshtërim – me lejen e Allahut të Gjithëmëshirshëm.

Lëvdata, shpëtimi dhe begatia e Allahut qoftë mbi Pejgamberin tonë Muhamedin.

Dialog në mes Shejkhut dhe Kharixhiut Terrorist.

Autor: Shejkh Muhamed Bazmul

Kharixhiu: Ata nuk janë terroristë. Ata janë nxënës dije që kanë xhelozë për fenë e tyre. Janë njerëz të devotshmërisë dhe adhurimit.

Shejku: Përkundrazi, ata janë terroristë Havarixh, edhe në qoftë se falen, agjërojnë dhe janë njerëz që kanë xhelozë (**për fe**). A nuk e sheh se i Dërguari i Allahut i ka përshkruar ata duke thënë:

“Në Fund të Kohës, do të dal një popull i ri në moshë, i papjekur e mendjelehtë. Ata do të flasin me fjalën e krijesës më të mirë. Imani i tyre nuk i kalon gurmazet e tyre. Ata do të dalin nga feja ashtu siç del shigjeta prej gjahut. Kështu që, kudo që t'i takoni, vrisni ata, ngase në vrasjen e tyre Ditën e Gjykimit ka shpërblim ai që i ka vrarë.”

Dhe ka thënë kur i ka përshkruar ata:

“Njëri prej jush do ta nënvlerësoj namazin e tij ndaj namazit të tyre dhe agjërimin e tij ndaj agjërit të tyre. Ata e lexojnë Kuranin, por ai nuk i kalon gurmazet e tyre, dalin nga Islami ashtu siç del shigjeta prej gjahut.”

Ky ishte Ibën Mulxhem, mësues i Kuranit, që e vrau Alijun – radijAll-llahu anhu –. A thuhet për Ibën Mulxhem se ai është nga njerëzit e devotshmërisë! Nuk e ka përshkuar me këtë cilësi vetëm se një poet nga Havarixhët i cili quhej Imran bin Hitan, ku ka thënë për goditjen e tij me të cilën e vrau Alijun – radijAll-llahu anhu –:

“O goditja e atij që ka devotshmëri, i cili kërkon përmes kësaj kënaqësinë që është tek Ai që posedon Arshin.”

Pra, këta që janë sot janë Havarixh, nuk na mashtrojnë namazi i tyre e as adhurimi i tyre dhe as ajo që cilësohen si nxënës dije.

Kharixhiu: Ata kanë dalë për shkak të fesadit (**trazirave**) dhe veprave të këqija që po bëhen. Ata duan përmirësim!

Shejkhu: Kjo nuk është rrugë për përmirësim, përkundrazi është rruga e fesadit. Ndryshimi i të keqes ka rrugën dhe metodën e saj të njohur tek njerëzit e dijes. Kurse metoda që kanë ata, nuk është tjetër vetëm se metoda e Havarixhëve dhe M’utezilive. Tek të cilët urdhërimi për të mirë dhe ndalimi nga e keqja është një nga mënyrat e kryengritjes kundër pushtetarit legjitim.

A është prej përmirësimit vrasja e muslimanëve?

A është prej përmirësimit përhapja e trazirave në vend dhe tek njerëzit? A është prej përmirësimit frikësimi i atyre që u është garantuar siguria?

A është prej përmirësimit vrasja e atyre (**jo-muslimanëve**) që kanë

hyrë në vendin tonë me lejen e prijësit apo atyre (**jo-muslimanëve**) që kanë bërë marrëveshje për mos-luftim me muslimanët?

A është prej përmirësimit vrasja e forcave të sigurisë në vend?

A është prej përmirësimit dhuna në muajin e bekuar të Ramazanit?

A është prej përmirësimit shkaktimi i rrëmujës dhe trazirave në mesin e njerëzve?

A është prej përmirësimit që t'i japësh mundësi armikut qafir e dashakeq, që të infiltrohet në mesin tonë?

Ata deshën që të ndryshojnë një të keqe, por ranë në një të keqe më të madhe se ajo (**që donin ta ndryshonin**). A nuk e dijnë se prej fjalëve të Selefëve është:

“Le të jetë i mirë urdhërimi yt për të mirë, dhe të mos jetë i keq ndalimi yt nga e keqja.”

Kharixhiu: Dialogoni me ta (**Havarixhët**). Dijetarët janë treguar të mangët duke i braktisur ata, e nuk kanë dialoguar me ta dhe nuk kanë shkuar te ata!

Shejkhu: Kjo kërkesë është e pabazë në shumë aspekte:

Aspekti i parë: Ku janë ata që të dialogojnë? Dialogu i Ibën Abbasit – radijAllahu ‘anhu – me Havarixhët përmes urdhrin të Halifes së Drejtë ‘Alij bin Ebi Talib – radijAllahu ‘anhu – ndodhi kur ata ishin pajtuar dhe ishin mbledhur në një vend, kurse tani ku janë ata? Ata janë fshehur. Nuk i njohim udhëheqësit e tyre që të dialogojmë me ta. Le të dalin në publik dhe le të paraqesin atë që kanë, që të hyjmë në dialog me ta! Pastaj, për ç’gjë të dialogojmë? Ata nuk kanë folur për ndonjë çështje që është për ta dialoguar.

Aspekti i dytë: Baza është që ata të shkojnë te dijetarët dhe ta

paraqesin atë që kanë në mënyrë që dijetarët t'ua japin ilaçin shërues – me lejen e Allahut – nga Kurani dhe Sunneti dhe në dritën e kuptimit të Selefëve të devotshëm, e jo dijetarët të shkojnë t'i kërkojnë ata, sepse kjo kërkesë bie ndesh me ajetin fisnik:

“Kur atyre u vjen ndonjë lajm i rëndësishëm që ka të bëjë me sigurinë ose frikën, ata e përhapin (në mesin e njerëzve). Në qoftë se këtë lajm do t'ia përcillnin (për shqyrtim) të Dërguarit dhe atyre që kanë autoritet (dijetarëve) në mesin e tyre, hulumtuesit përkatës do ta kuptonin atë prej tyre. Sikur të mos ishte mirësia e Allahut dhe mëshira e Tij, ju të gjithë do të ndiqnit djallin, përveç një numri të vogël.” En-Nisa, 83

Aspekti i tretë: Dijetarët nuk janë treguar kurrë të mangët – lavdia i takon Allahut të Lartësuar –. Pra, ata që në fillim të kësaj fitneje, gjatë ditëve të Luftës së Gjirit, mbajtën qëndrime të prera dhe kategorike. Ata sqaruan dhe paralajmëruan. Pasha Allahun, ata paralajmëruan ndaj këtij aktualiteti që po përjetojmë sot, dhe përmendën atë që e kanë nxjerr nga Kurani dhe Sunneti, duke u bazuar në kuptimin e Selefëve të Devotshëm se këto ideologji të shpijnë në këto gjëra. Dhe kjo sot është aktuale, që përputhet me atë që e përshkruan dhe paralajmëruan kundër saj.

Kush janë dijetarët e vërtetë? A janë ata të cilët udhëzohen me dritën e Dy Shpalljeve? Apo janë ata të cilët udhëzohen me zjarrin e fitneve, rrëmujës dhe trazirave? Porse çfarë bënë ata? Ata filluan duke i larguar njerëzit nga dijetarët, herë u thonë se ata s'kanë dije për aktualitetin, herë u thonë se ata janë dijetarë të sulltanëve, herë u thonë se ata janë agjentë të Amerikës, herë u thonë se ata janë dijetarë të dynjasë... vazhdon zinxhiri i gjatë i etiketimeve të tyre me të cilat i largojnë njerëzit nga dijetarët. Kështu që, i mashtruan të

rinjtë dhe i turbulluan se vet ata (**Havarixhët**) janë dijetarët prej të cilëve merret gjykimi i çështjeve aktuale!

Pra, dijetarët e identifikojnë sëmundjen dhe paralajmërojnë kundër saj dhe i përshkruajnë ilačin. Ata (**Havarixhët**) vet largohen dhe i devijojnë njerëzit nga dijetarët. Pastaj, tani na thonë: **“Dijetarët janë larg të rinjve”**. Kjo është një

shigjetë tjetër në mbajtësen e shigjetave të tyre me të cilën i gjuajnë njerëzit e dijes. Allahu ua ktheftë shigjetat e tyre në grykat e tyre të dështuara e të shkatërruara.

Kharixhiu: Ata (**Havarixhët**) janë dijetarët e rizgjimit dhe thirrjes (d’auetit), të cilët kontribojnë që të jenë ndërmjetësues në mes shtetit dhe atyre, atëherë përse nuk përfitohet prej tyre?

Shejkhu: Dijetarët e rizgjimit dhe thirrjes janë dijetarët tanë, siç janë: Shejkh ‘Abdul-‘Aziz Ali Shejkh, Shejkh Feuzan, Shejkh Ibën Gudejan, Shejkh Ahmed Jahja en-Nexhmi, Shejkh Rabij bin Hadi el-Medkhali, Shejkh Zejd el-Medkhalij, Shejkh Ubejd el-Xhabiri dhe vëllezërit e tyre. Kështu që, këta janë dijetarët e rizgjimit dhe dijetarët e d’auetit. Nuk kemi dëgjuar prej tyre se ata kontribuojnë përmes këtij ndërmjetësimi fatkeq (**siç po kontribuojnë Havarixhët përmes fitneve dhe trazirave, sh.p.**), madje ata – Allahu i ruajttë dhe i bekoftë – janë të një zëri se të rinjtë e kanë detyrë që të kthehen tek dijetarët dhe të mos rebelohen kundër udhëheqësve.

Kharixhiu: Shiko! Amerika po i zbaton komplotet e saja, kurse ne po pasojmë Amerikën.

Shejkhu: Këto janë politika. Këto çështje i kanë përsipër udhëheqësit tanë. Kurse detyra jonë është t’u japim hakun që ua ka

dhënë Allahu (**d.m.th. bindjen ndaj tyre**), tjerat përveç kësaj, nuk janë çështje që na takojnë neve. Andaj, ne vazhdojmë me adhurimin e Zotit tonë dhe u bindemi prijësve tanë në atë që është e mirë dhe nuk largohemi as sa një pëllëmbë nga bindja (**ndaj udhëheqësve**), përveç nëse shohim kufër të qartë tek ata, për të cilin kemi argument nga Allahu.

Kharixhiu: Ky është kufri i qartë. Miqësimi dhe armiqësimi (**el-Uela uel-Bera**) janë nga bazat e Teuhidit. Kjo është humbur dhe është fshirë nga metodologjia e mësimdhënies dhe ja na del që neve e miqësojmë Amerikën dhe nuk e armiqësojmë atë.

Shejkhu: Dijetarët e Sheriatit kanë folur për bazat e miqësimit dhe armiqësimit dhe ai (**Sheriati**) është referencë në shpjegimin e tij, e jo ju! Kështu që, a jeni kthyer tek dijetarët që t'i shikoni shtjellimet e tyre për këtë bazë? Si e keni bërë këtë gjë (**politikën me qafirat**) rrënues të bazës së miqësimit dhe armiqësimit, kurse ajo në realitet nuk e rrënon këtë bazë! Kini frikë Allahun dhe kthehuni tek dijetarët dhe kuptojini fjalët e tyre, do të shpëtoni me lejen e Allahut.

Heqja e saj nga metodologjia e mësimdhënies nuk është heqja nga feja, ngase feja është e ruajtur, Allahu është Plotësuesi i dritës së Tij, edhe në qoftë se këtë e urrejnë qafirat. Ne kemi besim të thellë tek Allahu pastaj tek udhëheqësit tanë dhe dijetarët tanë.

“Ata kanë për qëllim ta shuajnë Dritën e Allahut (Islamin) me gojë të tyre. Por Allahu e plotëson Dritën e Tij, edhe pse qafirat e urrejnë këtë.” Es-Saf, 8

Kharixhiu: Ne duam që të ndodhin luftërat e ashpra në mes nesh dhe Romakëve që janë përmendur në hadithe!

Shejkhu: SubhanAllah! SubhanAllah! Ç’është kjo ideologji? A ke ndonjë **(argument)** të Selefit për këtë çështje? A e ka vepruar këtë gjë ose a e ka kuptuar kështu këtë ndonjëri prej Sahabëve apo Tabi’inëve apo dijetarëve me peshë?!

Hadithet tregojnë se këto ngjarje do të ndodhin dhe nuk ka ardhur ndonjë nxitje në hadithe që të mendojmë në këtë mënyrë. Ne e zbatojmë Sheriatin e Allahut. Ne e kryejmë atë që e kemi për detyrë, ndërsa përkujdesjen e çështjeve ia lëmë Atij që ka në dorë pushtetin – të Madhëruarit e të Lartësuarit –.

Këto **(ideologji)** janë fatkeqësi. Të Allahut jemi dhe tek Ai do të kthehemi. Këtë metodë të të menduarit e shoh të njëjtë sikur metoda e Jehudëve të cilët besojnë në atë që quhet **“Armagedon”**, japin mund që të vij më shpejt ajo ndodhi. Kështu që, kjo është prej ndjekjes së rrugëve të Jehudëve. Allahu Ekber! Vërtetë këto janë ato rrugë.

“Pasha Allahun, do t’i ndiqni rrugët e atyre që ishin para jush (Jehudët dhe të Krishterët) hap pas hapi, saqë nëse ata do të ishin futur në vrimën e hardhucës, edhe ju do të ishit futur.”

Kini frikë Allahun, pendohuni tek Ai dhe kapuni pas Sunnetit dhe kthehuni tek dijetarët. Tregojuni atyre atë që keni dhe pyesni ata, do të gjeni shërim, dije dhe mirëqenie nga këto devijime – me lejen e Allahut të Lartësuar –. Me dijetarët kam për qëllim ata dijetarë për të cilët është dëshmuar për ta, siç është Shejkh Abdul-Aziz Ali Shejkh, Shejkh Salih el-Feuzan, Shejkh Gudejan dhe të tjerë nga vëllezërit e tyre. Islami dhe muslimanët kanë dobi prej tyre. Allahu ua shpërbleftë me më të mirën për atë që bëjnë për Islamin dhe Muslimanët. Amin.

Historitë më të çuditshme të Havarixhëve në kohët e lashta dhe në kohën tonë.

Autor: Shejkh Sulejman Ruhejli

Ja kështu i gjejmë sot të mëvonshmit prej tyre: i bëjnë qafira udhëheqësit musliman, madje ata bëjnë qafira dijetarët dhe njerëzit e thjeshtë.

Pasha Allahun o vëllai im! Njërit prej tyre i thamë: ne të sjellim ty fjalën e Shejkh ibën Bazit dhe Uthejmit.

Ai tha: “Nuk ka qafir më të mëdhenj sesa këta.” Pastaj më foli mua dhe Shejkh AbduSelamit, duke na thënë: “Ju nuk jeni murteda (prej atyre që kanë dalë nga feja). Jo, nuk jeni murteda. Ju jeni qafira që në origjinë, ju as që e keni njohur Islamin.” Pastaj, ne ishim në kohë haxhi dhe ai u drejtua nga haxhinjtë duke bërë me shenjë dhe thoshte: “I shikon ata haxhinj që janë më shumë se dy milion, nuk ka asnjë prej tyre që e njeh Allahun.”

Shiko këtë guxim të madh që kanë ata në tekfir.

Prej cilësive të tyre që ne shohim është se ata janë zemër vrazhdë. Ata veprojnë gjëra të cilat një njeri me natyrën e pastër ik prej tyre. Dhe për shkak të injorancës që kanë është se tregohen të devotshëm për gjëra që janë shumë më të vogla se sa ai **(krimi që ata bëjnë)**. Dhe do t’ju tregoj dy ngjarje. Një ngjarje që ka ndodhur më përpara dhe një ngjarje që ka ndodhur tani në kohën tonë.

Në kohët më të hershme, Havarixhët e parë, gjetën Abdullah ibën Khababin, shokun e Pejgamberit – sal-lAllahu ‘alejhi ue ‘ala Aalihi ue sel-lem – dhe e zunë rob bashkë me gruan e tij e cila ishte shtatzënë. Pastaj i morën me vete dhe ndërkohë që ata po ecnin, gjetën një derr

të një njeriu prej Ehlu Dhimeh (**Jehudët dhe të Krishterët të cilët kanë bërë marrëveshje me muslimanët dhe që jetojnë në shtetin Islam**). Njëri prej tyre e goditi me shpatën e tij dhe ia çau lëkurën, kurse tjetri tha: **“Ky është derr i një Dhimiju, si lejon që ta godasësh atë (derrin)?”** Kështu ai shkoi t'i kërkojë falje dhimijut derisa ai e fali.

Pastaj kaluan pranë disa frutave të hedhura për toke, dhe njëri prej tyre mori një frut dhe e futi në gojë, kurse një tjetër tha: **“Subhan Allah! Si e merr atë pa leje duke mos qenë e jotja?! Kështu ai e nxori atë nga goja. Pastaj erdhën tek Abdullahi – Allahu qoftë i kënaqur prej tij – dhe e vranë atë.**

Pastaj shkuan tek gruaja e tij, ajo u tha: “Unë jam grua shtatzënë. Kini frikë Allahun!” Ata ia çanë barkun, ia nxorën fëmijën dhe e therën atë.

Shiko, Subhan Allah! Guxojnë të vrasin atë Sahabi të nderuar, atë fëmijë që nuk ka asnjë faj dhe atë grua shtatzënë, kurse nga ana tjetër shkojnë i kërkojnë falje dhimijut për shkak se i goditën derrin.

Ndërsa në kohën tonë, të gjithë i kemi parë dy ngjarje të cilat janë të shkurtra.

E para: Ata (Havarixhët) therën një grua dhe ia prenë kokën, pastaj njëri prej tyre ngrihet duke valëvitur kokën e saj. Atëherë dijetarët e tyre filluan të kenë mospajtime se a i lejohet atij të prekë flokët e saj apo kjo është haram? Dhe nuk u ndalën (për të menduar) për vrasjen që i bënë asaj, e as që ishte problem kjo. Problemi është a lejohet që ai të prekë flokët e saj apo nuk lejohet.

Një i pranishëm: Dhe e vrau atë?!

Shejkhu: Po, e vrau! Pastaj ranë në mospajtim: a e ka haram sepse

ai ka prekur flokët e saj apo nuk e ka haram.

(E dyta): Kur ata vranë policin para disa ditësh në Rijad dhe e dogjën atë, ranë në mospajtim për fotografimin. A është hallall apo haram?

I pranishmi: Pra, ata vranë një musliman?!

Shejkhu: Po, e vranë dhe e dogjën gjithashtu! Pastaj, u ndalën dukemenduar për fotografimin, fotografimi që bëhet për të vërtetuar vrasjen e tij, a është hallall apo haram?

Pra, ata janë popull me zemër të vrazhdë, veprojnë gjëra të cilat një njeri me natyrë të pastër nuk i bën kurrë. Dhe për shkak të injorancës që kanë, ata tregohen të devotshëm për gjëra që janë shumë më të vogla se sa ajo **(krimi që ata bëjnë)**.

Havarixhët e ISIS

Grupi “Shteti Islamik i Irakut dhe Shamit” është një organizatë terroriste.

Autor: Shejkh Muhamed Ibën Hadi el-Medkhalij

Andaj, ky është pështjellimi dhe ky mashtrimi i bijve dhe rinisë tonë. Merren fëmijët dhe shtyhen duke u dërguar në vende të ndryshme, në beteja të ashpra, Allahu e di më së miri se çfarë u ndodh atyre. Jo! Ajo që është më shumë se kjo është se vet këto grupe që e quajnë veten e tyre **“grupe të xhihadit”** janë duke bërë luftë kundër njëri-tjetrit.

Grupi SHIISH (**Shteti Islamik i Irakut dhe Shamit**) lufton kundër SHIIG (**Shteti Islamik i Irakut dhe Gadishullit**), kurse SHIIG lufton kundër Al- Kaides, ndërsa el-Kaida lufton ku e di cilin, vrasje dhe luftë. Kjo është gjendja e tyre, neve e kemi parë me sytë tanë, d.m.th neve nuk jemi që mungojmë rreth asaj së çfarë ndodh në terren.

Ku është ky **“Islam”** në të cilin thirret?! Ku është ky **“xhihad”** në të cilin thirret?! Allahu e ka nderuar këtë ummet me xhihad, ummet i xhihadit, ummet i Muhamedit – sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem –. Por xhihadi ka kriteret e tij dhe kushtet e tij si dhe parimet e tij, po ashtu

ka edhe njerëzit e tij të kualifikuar që sqarojnë rregullat legislative të tij dhe ka njerëzit e tij të cilët urdhërojnë **(për luftë)** si komandantë. Atyre ju merret fjala dhe u bindet.

Kurse këta **(SHIISH, SHIIG, Al-Kaida)** janë thirrësa për në fitne (katrahurë, rrëmuje), dhe kjo që ata e quajnë **“xhihad”** është fitne. Dëshën apo s’dëshën ata, neve u themi me gojën plotë se ai është fitne.

E lusim Allahun – e Madhëruar e të Lartësuar – që t’i shpëtoj bijtë e muslimanëve prej tyre.

E gjithë lavdia i takon Allahut që u ka dhënë udhëheqësve të këtij vendi **(Arabi Saudite)** që ta sqaroj gjendjen e tyre. Që ditën e parë e kanë sqaruar dallimin në mes xhihadt dhe terrorizmit. Kjo është nga fatkeqësitë që i është sjellë

ummetit Islam, nga Afganistani e deri në Tunizi dhe deri te kufijtë e Turqisë dhe në botën Arabe, që e quajnë **“xhihad”** kurse ai në fakt nuk është xhihad, përkundrazi është fitne dhe shkatërrim.

E lusim Allahun për mirëqenie dhe shpëtim. O Allah! Shpëtoi ata, shpëtoi ata. O Allah! Na fal neve dhe muslimanët. E lusim Allahun e Madhëruar e të Lartësuar që t’i udhëzojë muslimanët e devijuar dhe të na udhëzoj neve në çdo gjë që është e mirë dhe t’i largojë të gjitha sherret nga vendi jonë, vendet Islame dhe muslimanët, dhe t’i largojë nga muslimanët të gjitha llojet e sherreve.

Vërtetë Ai është Bujari dhe Fisniku.

Grupi “SHIISH” nga ana e jashtme duken sikur e ndihmojnë Islamin por në realitet u shërbejnë armiqve të Islamit.

Autor: Shejkh Salih es-Suhejmi

Pyetje: (Pyetësi) tregon për atë që ndodh në vendin e tij, në një prej vendeve të muslimanëve dhe flet për atë që quhet “Ensaru-Sheri’ah”, këto emërtime?

Shejkh Salih es-Suhejmi: O vëllezër! Këto janë fitne të mëdha dhe nuk lejohet përkatësimi tek këto **(grupe)**.

Ajo që në tokën e Andaluzisë më bën që të kem antipati ndaj saj janë emrat (e udhëheqësve) si M’utemidi dhe M’utedadi

Nofka të një mbretërie që nuk janë në vendin e duhur të saj Sikur macja që krekoset duke u hequr si luani

Nga ajo që ata përshkruhen me të drejtë është dalja në shesh e këtyre grupeve **(xhemateve)** dhe përçarja e tyre ndërmjet veti si dhe luftimi ndërmjet veti, ndërsa armiku ka gjetur rehati prej tyre. Kurse këta e godasin njeri-tjetrin, e bëjnë qafira njëri-tjetrin, e vrasin njëri-tjetrin, e kanë bërë të lejuar gjakun e njëri-tjetrit, nën parulla dhe emërtime të shumta, prej tyre është: Ensaru- Sheri’ah, ajo që quhet SHIISH **(Shteti Islamik i Irakut dhe Shamit)**, ajo që quhet... emra të shumtë, ndoshta nga pamja e jashtme e tyre duken sikur anëtarët e saj janë prej muslimanëve dhe se ata i ndihmojnë muslimanët, kurse ajo që po ndodh është se ata e kanë vënë veten e tyre në shërbim të armiqve të Allahut.

Ata e kanë vënë veten e tyre në shërbim të armiqve të muslimanëve, ngase ata kur e emërtojnë veten e tyre më këto emra

dhe i bëjnë muslimanët qafira, dhe e bëjnë të lejuar gjakun dhe pasurinë e tyre, madje ndoshta edhe nderet e tyre.

Presin që gruaja të pastrohet nga menstruacionet për tre ditë derisa... Pejgamberi – sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem – urdhëroi që vajza të pritët që të pastrohet derisa t’i mbarojnë menstruacionet, ndërsa këta presin vetëm tre ditë, pastaj bëjnë zina dhe kënaqen me të dhe mendojnë se kjo mjafton që gruaja të pastrohet nga menstruacionet apo që të pastrohet mitra e saj.

O vëllezër! Unë po ju them se Islami është një xhemat i vetëm dhe Islami nuk është shumë xhemate. Është një xhemat, e ai xhemat është ata që janë në atë që ishte Pejgamberi – sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem – dhe shokët e tij. Ata janë besimtarët e sinkertë, të cilët e adhurojnë Allahun sipas fesë së drejtë dhe ndalen tek tekstet e Kuranit dhe Sunnetit dhe nuk i bëjnë qafira vëllezërit e tyre musliman.

Mjafton që ata i kanë hapur një vrimë Islamit dhe u kanë shërbyer armiqve të islamit, e ndjejnë apo nuk e ndjejnë këtë. Ata e bëjnë të lejuar gjakun e muslimanëve dhe mendojnë se është obligim të fillohet **(me luftë)** ndaj atyre që i bëjnë qafira **(d.m.th, muslimanët)** para se të fillojnë me qafirat, kufri i të cilëve është i njohur dhe është i padiskutueshëm.

Kështu që, këto emërtime nuk shërbejnë për asgjë fare. Porse ajo që merret në konsideratë është zbatimi i fesë së saktë, e ai është Xhemati. Kurse Xhemati është ajo në të cilin ishte Pejgamberi – sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem – dhe shokët e tij. Kurse ajo që ndodh nga ana e tyre, e që është konsiderimi hallall i gjakut të muslimanëve dhe vënja e tyre në lojë dhe vlerave të tyre si dhe dëmtimi i vendeve të muslimanëve, pra këta –uAllahi – nuk i shërbejnë vetëm se armiqve

të Islamit.

I kanë bërë muslimanët që të përplasen me njëri-tjetrin, madje ka në mesin e disave prej këtyre grupeve ku gjen dy vëllezër, njëri vëlla i është bashkangjitur njëfarë grupit dhe ai vëllai tjetër i është bashkangjitur njëfarë grupi tjetër, ndoshta e kanë vrarë e prerë njëri-tjetrin. Çdo ditë vritet prej tyre me qindra, e mos qofshin me mijëra ndonjëherë.

Nuk ka ndryshim e as fuqi vetëm se me Allahun.

A ka xhihad në Siri dhe si është puna e grupeve që luftojnë atje, si SHIISH, etj?

Autor: Shejkh Abdullah el-Bukhari

Pyetje: Ky pyetës po ashtu pyet – Allahu ju bekoftë – rreth luftës në Siri dhe gjykimit të saj?

Shejkh Abdullah el-Bukhari: Përgjigja – Allahu ju bekoftë – është se ne themi: për sa i përket kësaj çështjeje të rëndësishme, çështjes së Sirisë dhe fatkeqësitë që zbresin mbi banorët e saj.

Së pari: Ne themi se është obligim për çdo musliman dhe muahid **(çdo njeri që e veçon Allahun me adhurim)** që ta lus Allahun për vëllezërit e tij musliman në të gjitha vendet e botës, dhe prej tyre është Siria në veçanti, ta lus Allahun – të Madhëruarin e të Lartësuarin – në namazet e tij, në çastet e vetmisë së tij, në kohët e pranimit të lutjeve, t'i kërkoj kohët e pranimit të lutjeve, ta lus Allahun që ta largoj dëmin që ka zbritur mbi ta dhe ta ngre fatkeqësinë që ka zbritur mbi ta, si dhe t'i largoj sherret dhe trazirat **(fitnet)** nga ne dhe nga ata, dhe t'i mëshirojë të moshuarit, të vegjlit,

gratë dhe të rinjtë e tyre dhe e ta lus – të Madhëruarin e të Lartësuarin – që t'i ndihmoj të dobët në çdo vend.

Pa dyshim, se ajo që ka zbritur mbi ta është një bela e madhe dhe ajo në të cilin ndodhen ata, që janë vrasja, shkatërrimi, plaçkitja dhe rrëmbime. Ky është një problem i madh dhe tejet i tmerrshëm. Andaj, e lusim Allahun e Madhëruar, Zotin e Arshit Madhështor, me Begatinë dhe Bujarinë e Tij dhe me Fuqinë dhe Forcën e Tij që ta largoj atë që ka zbritur mbi ta, nga fatkeqësitë dhe dëmet, dhe t'i ndihmoj të dobët nga Ehli Sunneti, në çdo vend. Vërtetë ai është Bujar dhe Fisnik. Kjo është pika e parë.

Pika e dytë: kur ndodhi ajo që ndodhi në shtetin e Sirisë me kryengritjen e disa njerëzve në fillim, kundër atij pushtetarit të padrejtë, të shthurur, tiran – kërkojmë mbrojtjen e Allahut –. Ata u ngritën kundër tij dhe disa prej tyre i kapën armët, njerëzit vinin e pyesnin dhe pasuesit e hakut dhe kërkuarit e hakut nga banorët e atij vendi **(Sirisë)** pyesnin çfarë të bënin.

Kështu që, pasuesit e Sunnetit dhe dijetarët e mëdhenj të Sunnetit u përgjigjën pa servilizëm dhe jo për ndonjë përfitim personal, siç ndodhi me të tjerët, oportunistët të cilët dihatin mbrapa fitneve **(trazirave)** dhe i kërkojnë ato.

Dijetarët dhanë fetva me hak **(me drejtësi)** dhe në dritën Profetike që: të mos bëni gjë **(kryengritje kundër Asadit, sh.p.)** dhe mos i kapni armët dhe shmangiuni fitnes **(trazirave)**. Jo për atë se ai (Beshar el-Asadi) mëkatar, kriminel ka shenjtëri të Islamit, jo! Në të kaluarën, dijetarët e Sunnetit kanë folur për babanë e tij **(Asadit)** dhe për gjykimin ndaj tij.

Nga kushtet e Ehli Sunnetit në lidhje me kryengritjen ndaj pushtetarit qafir, kufri i të cilit është vërtetuar me siguri të plotë dhe

me argument nga Allahu, dijetarët kanë përmendur kushte edhe në qoftë se pushtetari është qafir, kufër i cili të nxjerr prej fesë. Në mesin e atyre **(kushteve)** është që neve të shohim kufër të qartë tek ai, ta shohim kufrin dhe të jetë i qartë dhe se për këtë kemi argument nga Allahu dhe ky, kundër të cilit bëhet kryengritje, të mos shkaktoj kjo kryengritje pasoja më të këqija se sa mbetja e tij **(në pushtet)** dhe shkatërrim më të madh se sa mbetja e tij. Kështu që, nëse largimi i tij **(pushtetarit)** do të shpie në një dëm më të madh, nuk lejohet që të ngresh armët kundër tij sipas Ixhmas **(konsensusit)** të dijetarëve.

Nga kushtet është që të kenë fuqi për ta hequr **(pushtetarin)**, por nëse nuk kanë fuqi për ta hequr atë, gjithashtu nuk lejohet **(kryengritja kundër tij)**. Dijetarët e dhanë këtë fetva që nuk u lejohet atyre t'i ngrenë armët **(në Siri)**.

Oportunistët nga pasuesit e epsheve dhe bidateve si dhe ata të cilët hanë dhe nxjerrin të ardhura përmes derdhjes së gjakut, thanë: **“Ata (dijetarët e sunnetit)! Shikoni! E mbrojnë filanin (Asadin) dhe e mbrojnë atë...”** Dijetarët e Sunnetit nuk e kanë mbrojtur këtë të prishur e mëkatar, porse qëllimi i tyre ishte që të mbrohet gjaku i muslimanëve dhe të dobëtëve nga këndvështrimi i Sheriatit të pastër e pastrues.

Andaj, juve ju takon që të shikoni: kur konflikti u shtua akoma më shumë gjatë këtyre tre viteve që kanë kaluar, dhe për çdo ditë ky krimineli i shton krimet e tij. Ai vrau me qindra e mijëra, e dhjetëra burra, si dhe dhjetëra mijëra. Po kështu ka vepruar edhe me fëmijët, me vendin, robërit, i shkatërroi shtëpitë dhe vazhdon akoma të jetë në karrigen e tij **(të pushtetit)**.

Dhe ajo që shpresohet me heqjen e tij **(nga pushteti)**, nuk u realizua! Kurse fesadi që erdhi më vonë me vrasjet e tij, u

shumëfishua akoma më shumë fesadi të cilin po e ushtron ai. Nuk mjafton me kaq. Madje, ai i ka thirrur dhe ka kërkuar ndihmë nga Rafidijtë e fëlliqur e të ndyrë. Pra, këta erdhën dhe filluan ta ndihmonin me batil (**kotësi, të pavërtetë**) duke u bazuar në batil. E lusim Allahun për mirëqenie dhe shpëtim. Fjalët e atyre endacakëve nuk i dëmtuan dijetarët, të cilët e kundërshtojnë hakun (**të vërtetën**), të cilët bëjnë tregti me gjakun (**e njerëzve**) siç bënë tregti me gjak në Irak, dhe bënë tregti me gjak në vende tjera të Allahut përpos Irakut.

Ata, as Islamin nuk e ndihmuan e as armikun nuk e mposhtën. Ata nuk flasin me Sheriatin e pastër të Pejgamberit – sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem –. Ata janë

njerëzit më injorantë rreth fesë së Allahut dhe njerëzit më gënjeshtarë ndaj Sheriatit të Allahut.

Kur ndodhi ajo që ndodhi dhe çështja është përkeqësuar siç e shikoni edhe ju, disa njerëz filluan të kapin këtë e atë (prej armëve), të luftojnë njëri-tjetrin dhe të ushtrojnë dhunë, dhe të luftojnë. Dhe në radhët e tyre hyri kush hyri, dhe erdhën njerëz (**në Siri**) prej vendeve të ndryshme dhe u ngritën flamujt, më shumë se një flamur, më shumë se një xhema (**grup**), më shumë se një fraksion. Çdonjëri jep kushtrimin dhe brohorit dhe pretendon se ka lidhje me Lejlën, ndërsa Lejla ua refuzon këtë lidhje.

Flamuj të panjohur dhe flamuj të paqëndrueshëm dhe jo të shëndosh si dhe flamuj të dyshimtë, të shpikur dhe flamuj të bidatçijve, e kështu me radhë. Andaj, për ç’gjë lufton dhe nën flamurin e kujt po lufton? Kurse Pejgamberi – sal-lAllahu ‘alejhi ue ‘ala alihi ue sel-lem – thotë, siç qëndron tek Sahihu i Muslimit dhe të tjerëve:

“Kush lufton nën një flamur të panjohur, ka vdekur ashtu sikurse

në Xhahilijet.”

Ai – sal-lAllahu ‘alejhi ue ‘ala alihi ue sel-lem – thotë në atë që e ka nxjerr Buhariu në Sahih:

“Imami është një mburojë, luftohet mbrapa tij.”

Patjetër që të ketë një Imam dhe një flamur të vërtetë, të saktë, të qëlluar. Të mos ketë parregullsi dhe rrëmuje, si dhe të mos ketë gjëra të tjera... të jetë një flamur i saktë dhe të jetë një flamur me një imam të saktë që të lidhesh pas tij.

Ai – ‘alejhi salatu ue selam – ka thënë:

“Imami është një mburojë, luftohet mbrapa tij.”

Do të thotë që ai të jetë mbrojtje për ta. Pra duhet patjetër të jetë i pranishëm një imam. Nuk është **(zgjedhja e imamit)** që të vijmë unë e ti, filani dhe fisteku, edhe mbaroi me kaq, ti je imami. Kjo është lojë dhe shpifje ndaj Sheriatit si dhe tallje me fenë e Allahut. Nuk shkojnë punët kështu.

Në këtë krizë, shumë kanë bërë tregti dhe pasuesit e epsheve kanë bërë rrëmuje të madhe përmes faqeve të internetit dhe të tjerave pos këtyre, ngase fitneja është e pranishme dhe fitneja është sikurse zjarri, ka nevojë për drunj dhe lëndë djegëse. Atëherë kush është lënda djegësve e këtyre fitneve nëse ajo

fiket?! Nuk mund të jenë lëndë djegëse e këtyre fitneve vetëm se të rinjtë e Ummitit, të cilët e kërkojnë hakun, por ata nuk udhëzohen me ata që do t’i marrin për dore për në rrugën drejtë.

Kështu që, bëhet tregti me ta, ata që bëjnë tregti me gjak dhe i hedhin ata në amullitë e këtyre fitneve në mënyrë që ta ndezin zjarrin me ta dhe ju pëshpërisin atyre se nuk ka në mes teje dhe xhenetit

vetëm se të rrasesh këtu. Dhe të bësh kështu. Sikur Xhenneti është në duart e tyre dhe dera e xhenetit është tek ata dhe se ata janë çelësi i xhenetit.

“Dëshmia e tyre do të shkruhet dhe ata do të pyeten.” Ez-Zukhruf, 19

Këto kriza – Allahu ju bekoftë – siç thashë se shumë prej tyre kanë bërë tregti përmes këtyre krizave, ua kanë pështjelluar çështjet njerëzve dhe i fusin në ngatërresa dhe i shanë dijetarët e Sunnetit dhe i akuzuan ata se kanë bërë mëkate të mëdha dhe disa prej tyre i shpallën qafira dhe disa prej tyre i shpallën zindika **(të pafe)** dhe e lejuan gjakun e shumë njerëzve – Allahu na ruajttë –.

O vëllezër! I lumtur është ai që këshillohet nga tjetri. Shumë prej atyre që Allahu ua kishte shkruar të shpëtojnë dhe u kthyen nga ato vende **(të luftës)** dhe rrëfejnë për tmerret e të rinjve që janë në moshën e disave prej jush. E blejnë dhe e shesin të riun. Të shesin dhe të blejnë dhe bëjnë tregti me ty.

(Ata të pyesin) nëse ke hyrë nga ky drejtim apo ai drejtim, siç bënë me Irakun. Kur disa të rinj shkuan në emër të xhihadit dhe luftës, ata bënë shitblerje me ta, ose ua shisnin Rafidijve të fëlliqur ose të tjerëve nga armiqtë e fesë. Kështu ata binin pre. Kështu kanë vepruar në më shumë se një vend. Dhe **ata (që janë kthyer nga lufta, sh.p.)** rrëfejnë për tmerret.

Pastaj, më thoni për Zotin tuaj! A nuk ka në mes këtyre flamujve të ngritur prej atyre fraksioneve, a nuk ka në mes tyre luftë dhe maskara kundër njëri-tjetrit?! A nuk ka në mes tyre luftë dhe masakra kundër njëri-tjetrit?! Deri javën e kaluar **SHIISH-i, (Xhebhету) Nusra** luftojnë njëra-tjetrën, e ku e di unë kush tjetër... kërkuesit e udhëheqjeve të cilët e kundërshtojnë hakun dhe nuk pajtohen me

pasuesit e hakut. Kërkojmë mbrojtje prej Allahut nga kjo gjë.

Ky e vret këtë, e ai e vret atë tjetrin, kurse ai e vret atë të dytin, të gjitha këto në emër të **“Xhihadit”**. E prishën imazhin e këtij emri të vyer – siç ju thashë dje – i është prishur imazhi këtij emri fisnik dhe këtij adhurimi fisnik, të pastër, të dëlirë, i është prishur imazhi me veprat e shumë njerëzve – nga ata të cilët e injorojnë fenë e Allahut. Ose duket patur dije, ndoshta ndonjëri prej tyre e di, porse gjykon me epsh ose gjykon me injorancë – Allahu na ruajttë –, ose gjykojnë me të dyja bashkë.

Kështu që, ndodhën fitne dhe sherri i tyre si u shtua dhe u përhap në shumë vende, disa prej tyre (**sherreve**) ndoshta edhe në këtë vend. Për këtë arsye, dijetarët dhanë fetva dhe një grup dijetarësh, dijetarët e Sunnetit dhe dijetarët e hakut, siç është kolosi Shejkh Salih el-Feuzan, si dhe të tjerë nga dijetarët e Sunnetit si Shejkh ‘Abdul-Muhsin el-‘Abbad, Shejhu jonë ‘Abdul-Muhsin dhe Shejkhu jonë Shejkh Ubejdi si dhe të tjerë nga dijetarët, se kjo luftë konsiderohet fitne, kështu që është për detyrë largimi prej saj. Allahut – të Madhëruarit dhe të Lartësuarit – i lutet që ta ngrejë atë që ka zbritur nga dëmi dhe fatkeqësia.

Çka bëjnë ata (**që thërrasin në fitne**), i marrin paratë dhe hanë e pinë dhe bëjnë tregti me ato para, kurse me mijëra nga të pastrehët nëpër kampe vdesin nga uria dhe sëmundjet, dhe vdesin duke lypur, etj. Fëmijë, gra, burra, të paaftët, dhe shumë e shumë gra kanë ngelur pa mahrem (**të afërm**), pa familje. Cili është shkaku Allahu ju bekoftë?!

Kjo është ajo që besojmë ne dhe me të cilën e adhurojmë Allahun tani. Është detyrë që të mos shkohet (**për luftë**) në ato vende (**Siri**).

Porse i lutet Allahut – siç thamë – që ta largojë dëmin që ka zbritur mbi ta.

Nëse do që të bësh diçka për ta, nëse do të japësh sadaka nga pasuria jote, atëherë jepe tek autoritetet përkatëse zyrtare në shtet, jo t'ua jepni atyre që ndalen nëpër rrugë dhe xhamia. **(Thonë)** hajde të mbledhim para... mos u jep, mos i jep askujt. Nëse duhet patjetër që t'u japësh refugjatëve, varfanjakëve, skamnorëve dhe atyre që janë goditur me fatkeqësi në ato kampe të refugjatëve, atëherë duhet që shteti t'i marr këto para dhe nëse shteti do t'i ndihmoj muslimanët atje të cilët janë goditur me dëme, të ketë një autoritet zyrtar që drejtohet nga vet shteti. Nëse do të japësh, atëherë jepua këtyre.

Mos jep lart e poshtë, andej e këtej, kurrresi. Shumë prej tyre i marrin paratë dhe bëjnë biznes me to dhe trafikojnë. Këto para bien në duart të pabesa dhe të pandershme dhe i luftojnë muslimanët përmes këtyre **(parave)**. I bëjnë qafira muslimanët.

Halifeja i pretenduar në Irak është një dextrall dhe gënjeshtar i poshtër.

Autor: Shejkh Salih es-Suhejmi

Pyetje: Allahu ju dhëntë të mira. Me këtë rast, na thoni ndonjë fjalë rreth Hilafetit Islam që u shpall dje?

Shejkh Salih es-Suhejmi: Ah! Po. Ma sha Allah! O vëllezër!

“Fesadi (mëkatet dhe mosbindja ndaj Allahut) është shfaqur në tokë dhe në det për shkak të asaj që punuan duart e njerëzve.” Er-Rum, 41

Dhe ky fesad është ose përmes neglizhencë ose përmes ekstremizmit. Përmes neglizhencës është nga ana që shajnë fenë, pasuesit e laicizmit dhe liberalizmit, thirrësit e sherrit dhe thirrësit gojëlig, thirrësit e imoralitetit, thirrësit e shfaqjeve teatrale si dhe thirrësit e **“Tash Ma Tash” (komedi me seriale)**, e ku e di ti se çfarë është **“Tash Ma Tash”**? Qajnë për të sepse nuk është më **(nuk transmetohet). Kjo ishte kategoria e parë.**

Kategoria e dytë:

Thirrësit e ekstremizmit nga veprat e Havarixhëve dhe ata që e marrin rrugën e tyre. Sot mendjelehtët kanë shpallur themelimin e pretenduar të **“Hilafetit Islam.”** Këto marifete i njohim që prej 80 vitesh. Ata i japin besën një Halifeje të fshehtë duke u bazuar në menhexhin e tyre të prishur. Dhe të gjithë kane betime sekrete ndaj një personi të panjohur.

Sot e shpallën atë **(Halifen Ebu Bekër el-Bagdadij)** dhe ata shpesh kanë shpallur **(Halife)**, pastaj nëse vritet ai që është shpallur apo se ka shkuar ai që është shpallur, vijnë me Halife të ri. Kjo është afër **(e ngjashme)** me Mehdiun e Rafidijve – Allahu na ruajttë –. Kështu që, ky Hilafet që është shpallur, d.m.th na qenka Hilafeti i të gjithë muslimanëve. Ai është thirrur Halefija i muslimanëve pasi që ka masakruar dhe ka bërë atë që ka bërë me vëllezërit në Irak.

Nuk është në mirësi as ai e as armiqtë e tij nga Rafidijt, të dyja palët nuk ia duan të mirën Umetit Islam. Andaj, ne e kemi detyrë që të paralajmërojnë për të dyja palët – ndaj tij dhe ndaj armiqve të tij. Që të gjithë janë në një sherr të vazhdueshëm. Që të gjithë janë në devijim. Që të gjithë ndoshta bien në ujdi fshehtazi për ta armiqësuar Ehli Sunnetit dhe Xhemin.

Andaj, paralajmëroni nga ky betim besëtytnor dhe ky mashtrim që

e kanë quajtur: **“Halifeja i muslimanëve në këtë kohë.”** Ky është dexhall (**Ebu Bekër el-Bagdadij, sh.p**) dhe gënjeshtar i poshtër nga thirrësit e të pavërtetës. I masakroi muslimanët në Sham (**Siri**), tani ka ardhur t’i masakroj muslimanët në Irak. Ai ka bashkëpunuar me tagutin e Shamit në masakrimin e muslimanëve, dhe për këtë arsye taguti i Shamit ka hequr dorë plotësisht prej tij, nuk e lufton atë sepse ai e furnizon atë me naftë nga Dejzur (**qytet në Siri**).

Porse, tani bashkëpunojnë të gjitha forcat e liga dhe prapa tyre qëndron Perëndimi, me të mëdhenjtë dhe të vegjlit e tij. Thirrësit e sherrit tek ajo që

quhet **“Shteti i Hilafetit”** apo **“Shteti Rafidijve”**, të gjitha këto emërtime i janë vërsulur Islamit dhe muslimanëve.

E lusim Allahun – e Madhëruar e të Lartësuar – që ta ngre Fjalën e Tij dhe ta ndihmoj fenë e Tij dhe t’i poshtëroj njerëzit e sherrit e që janë pasuesit e bidateve dhe epsheve si dhe armiqtë e fesë kudo qofshin ata, ekstremit apo neglizhent. Kështu që ata janë dexhalla. Kujdes, e mos keni punë me ta.

Pra, kur u themelua shteti i tyre në një vend të caktuar, njëri nga përkrahësit e tij pretendonte se e ka parë Pejgamberin dhe se ai u paska thënë: Filani do t’ju prijë në namaz si Imam, unë nuk do t’ju prijë. Do t’ua fal namazin filani prej njerëzve. Apo se Xhibrili u ka prirë si imam në filan vendi. A po e shikoni mashtrimin që ata po pretendojnë?! E lusim Allahun për mirëqenie dhe shpëtim.

Kështu që, muslimanët e kanë detyrë që të jenë syçelë. Siç i porosita dje vëllezërit në Irak, siç i kam porositur që prej kohësh në vende të ndryshme: të rrinë nëpër shtëpinë e tyre, nëse ata sulmohen,

atëherë ata le ta mbrojnë veten e tyre dhe ai që vritet **(për të mbrojtur, sh.p)** pasurinë e tij apo nderin e tij apo veten e tij, atëherë ai është shehid. Porse të mos luftoj përkrah të gjithë këtyre grupeve, të gjitha këto grupe janë në devijim qoftë **“Shteti i Rafidijve”**, apo **“Shteti i Shamit dhe Irakut” (SHIISH)**, apo **“Shteti i Hilafetit të pretenduar.”**

Të gjithë këta grupe janë kundër Ehli Sunnetit dhe Xhematit. Andaj, mos u merrni me ta dhe neve as që kemi punë me ta. Përkundrazi, ta adhurojmë Allahun dhe të mësojmë dhe ta kuptojmë fenë e Allahut derisa të qetësohet situata dhe të jemi rehat nga i shthururi.

Realiteti i Xhebbhetu-Nusra dhe SHIISH që luftojnë në Siri.

Autor: Shejkh Salih es-Suhejmi

Pyetje: Disa të rinj të entuziazmuar pas Xhihadit, kanë shkuar në Siri dhe i janë bashkangjitur një xhemati që quhet **“ed-Deuleh el-Islamijeh” (Shteti Islam)** dhe thonë se ajo që është përhapur se ata po vrasin dhe terrorizojnë, nuk është e vërtetë. Pra, cila është fjala e saktë për këtë xhemat (**grup**), Allahu ju bekoftë?

Shejkh Salih es-Suhejmi: Fjala e saktë është se ai është një grup Kharixhij Tekfirij. Ata e kanë vrarë djalin e djalit të tezës sime para pak ditësh, me pretendimin se ai është murted (**i dalë nga feja**). Sepse ai ishte në një front tjetër kundërshtar. Të dyja frontet e kanë gabuar rrugën, qoftë ajo që quhet (**Xhebbhetu**) Nusra apo SHIISH-i, porse ky (**SHIISH**) është më i keq. Që të dy grupet nuk i respektojnë lidhjet e besimtarit, as farefisën e as marrëveshjet.

Mjafton marrëzia që e kanë shpallur para dy apo tre ditëve duke u nisur nga pretendimi i dhënies së besës ndaj Halifes, për të cilin pretendojnë se është Halifeja i muslimanëve. Punën e parë që e bëjnë me disa të rinj tanë që u janë bashkangjitur atyre dhe me të cilën fillojnë është thyerja e besës (**ndaj prijësit musliman**) me të cilin janë lidhur. Dhe ju e dini gjykimi e thyerjes së besës (**ndaj prijësit**). Që të gjithë neve jemi të lidhur me besën (**ndaj prijësit**) dhe ju jeni të lidhur me besën ndaj prijësit në këtë vend.

Kështu që, kjo është mashtrim dhe tradhti. Tradhtarit i ngrihet një flamur dhe i shkruhet sipër se kjo është tradhtia e filanit. Ai që e thyen besën është në rrezik. Ai është në rrezik. Ai që e përçan xhematin, qoftë edhe sa një pëllëmbë dhe vdes, atëherë vdekja e tij

është sikur vdekja e Xhahilijetit. Dhe kush heq dorë nga bindja (ndaj prijësit) dhe e përçan xhematin, do ta takoj Allahun duke mos patur as edhe një argument të vetëm.

Pra, këta i thyejnë marrëveshjet dhe i shkelin marrëveshjet, janë plotësisht larg nga e vërteta. Ata i bëjnë qafira dijetarët, i bëjnë qafira udhëheqësit tanë dhe nuk kanë brengë tjetër vetëm se tekfirin, kjo është ajo që ata dinë dhe besojnë se kjo është Feja. I kanë mashtruar fetvat, të cilat fetva i japin disa budallenj mbrapa perdeve.

Ata **(që japin fetva)** janë dy lloje:

(Lloji i parë janë) myftilerë që janë japin fetva dhe janë bashkë me ta **(nëpër mejdanet e luftës me grupet si SHIISH, Nusra, sh.p.)**. I kanë marr ata për dijetarë dhe janë lidhur me ta dhe nuk i kthehen Gjykimit të Allahut, nuk i kthehen dijetarëve edukatorë. Këta janë të kësaj natyre.

(Lloji i dytë) janë myftilerë që japin fetva e që rrinë ulur, ndoshta japin fetva duke qenë në vendin tonë **(Arabinë Saudite)** dhe i përkrahin ata duke i inkurajuar që të shkojnë në kremator, ku i djegin të rinjtë e muslimanëve pa ndonjë farë synimi.

Ata luftojnë në një flamur të panjohur dhe nën një flamur të një partishmëriedhe nën flamuj të Xhahiljetit, kurse Pejgamberi – sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem – thotë:

“Nuk është prej nesh ai që lufton nën një flamur të panjohur.”

Ai lufton për partishmëri apo thërret për në partishmëri. Ata janë injorantë, mendjelehtë, të rinj në moshë, të papjekur. Pejgamberi – sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem – ka paralajmëruar për ta duke thënë:

“Sikur t’i takoja ata (Havarixhët), do të kisha vrarë mu ashtu siç

janë vrarë (populli) i Adit.”

Dhe ka thënë:

“I vrari më i mirë është ai që e kanë vrarë ata (Havarixhët), dhe ata (Havarixhët) janë të vrarët më të këqij nën këtë qiell.”

Dhe ka treguar se ata janë qentë e Zjarrit dhe se ata e lexojnë Kuranin, por ai nuk i kalon gurmazet e tyre dhe se ata dalin nga feja ashtu siç del shigjeta nga harku, nuk kthehen tek ai derisa të kthehet shigjeta tek vrima e saj **(harku nga ka dalë, sh.p)**. I ka quajtur: **“Qen të Zjarrit.”** Dhe ka treguar se ata do të shfaqen në çdo gjeneratë, çdo herë që shfaqët një grup prej tyre, ata do të shuhën **(vriten)** derisa të shfaqet me ta Dexhalli.

Dhe ka treguar se ju do ta nënvlerësoni namazin tuaj ndaj namazit të tyre dhe adhurimin tuaj ndaj adhurimit të tyre dhe se ata e lexojnë Kuranin, por ai nuk i kalon gurmazet e tyre. Si dhe cilësi tjera të tyre të cilat i ka sqaruar Pejgamberi – sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem –.

Ata janë vrasësit e Alijut, vrasësit e Uthmanit, vrasësit e Alijut – radijAll-llahu anhu dy –. Ata i vrasin muslimanët dhe i lënë të lirë idhujtarët. Siç ka treguar për ta Besniku dhe i Besueshmi – sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem –. Paraardhësit e tyre **(Havarixhët)**, vrasësit e Uthmanit, njëri prej tyre hipi mbi kafkën e pastër, mbi kafkën e Uthmanit pasi që ia ndanë **(kafkën)** nga koka e tij, ky pretendues i mallkuar ka thënë: **“Pasha Allahun! Nuk kam njohur ndonjë ditë prej ditëve të Allahut dhe as ndonjë ditë prej ditëve të Xhihadit, më të mirë se kjo ditë.”**

Kurse vrasësi i Alijut – radijAll-llahu anhu – e ai është AbduRrahman ibën Mulxhem, ka thënë: “E kam lyer me helm këtë thikë dhe ajo ka nëntë tehe, tre prej saj janë për Allahun dhe të Dërguarin e Tij, dhe gjashtë prej këtyre teheve që i kam helmuar janë për urrejtjen që kam ndaj Alijut.” radijAll- llahu anhu.

Për këtë arsye shoku i tij (i AbduRrahman Mulxhemit) Imran ibën Hittan, thotë

(në një poezi duke e lëvduar vrasësin e Alijut):

“O goditja e atij që ka devotshmëri, nuk ka synuar me të vetëm se të arrij faljen që vjen prej Atij që posedon Arshin. Vërtetë e kujtoj sot atë dhe e llogaris si krijesën më të përsosur tek Allahu prej njerëzve.”

Njëri nga Selefët i kundërpërgjigj duke i thënë:

“O goditja e atij që ka ligësi, nuk ka synuar me të vetëm se të arrij shkatërrimin që vjen prej Atij që posedon Arshin. Vërtetë e kujtoj sot atë dhe e llogaris si krijesën më të keqe tek Allahu prej njerëzve.”

Nga shenjat e tyre **(Havarixhëve)** – o vëllezër – është fshehtësia. Feja jonë është fe e hapur **(e qartë)** apo fe e fshehtë?! Fe e hapur apo fe e fshehtë?! Është fe e hapur **(e qartë)**. Nuk ka te ne diçka që ta fshehim. Për këtë arsye, Sufjani – Allahu i Lartësuar e mëshiroftë – thotë: **“Nëse i shikoni njerëzit se flasin fshehurazi pa praninë e muslimanëve të thjeshtë (masës së gjerë), dijeni, se ata janë në themelin e devijimit.”**

Unë kam bërë një thirrje nga Xhamia e Pejgamberit para katër ditëve duke e refuzuar pretenduesin **(Ebu Bekër el-Bagdadijn)** e Hilafetit dhe ata dëxhalla endacak që ia kanë dhënë besën atij. Shpresoj që ta përhapni këtë në çdo vend, me shpresë se na llogaritet **(prej veprave të mira)** tek Allahu – i Madhëruar e i Lartësuar –.

Po ashtu, kam dhënë leje që këtë përgjigje ta përhapin ata që duan. Po.

Një i ri shkoi të luftojë në Siri kundër Besharit, por atje pa se Muslimanët vrasin njëri-tjetrin.

Autor: Shejkh Salih es-Suhejmi

Ata të cilët nisen dhe luftojnë nën flamuj të panjohur e të paditur, a përmbushen këto kushte, edhe në qoftë se përmbushen disa prej tyre?! Kurrë. Përkundrazi, ata luftojnë...

Na morri në telefon vëllai për të cilin ju tregova se u vra, ai shkoi **(në Siri)** dhe nuk mori leje nga nëna e tij, por pasi që mbërriti atje, na morri në telefon dhe na tha: **“Unë erdha (në Siri) ta luftoj atë tiranin (Beshar el-Asadin) i cili i ther Muslimanët në Sham, por nuk pashë luftë kundër këtij tirani, në fakt pashë se Muslimanët luftojnë njëri-tjetrin dhe se unë do të kthehem tek ju dhe të kërkoj ndjesë o babai im dhe oj nëna ime. Nesër do të përgatitem dhe do kthehem. Nuk do të marr pjesë në këtë luftë që e pandehin ata.”**

Kështu, ata e vranë këtë **(që deshi të kthehet në shtëpi, sh.p)**, e likuiduan, e vranë menjëherë dhe ata budallenjtë thanë se ai u vra shëhid, kurse vet ata janë që e vranë dhe e likuiduan, për këtë na lajmëruan disa që erdhën pas kësaj **(ngjarje)**. Andaj, kini kujdes o vëllezër! Kujdesuni për fëmijët tuaj. Ata e kanë obligim që t’u kthehen dijetarëve edukatorë dhe t’i pyesin ata, e jo t’i

pyesin demagogët, të maskuarit, të infiltruarit, misteriozët, budallenjtë, vocërrakët, mendjelehtët, injorantët, ndonjëri prej tyre nuk di si falet namazi, ndonjëri prej tyre nuk di të dallojë Teuhidin nga Shirku.

Me njërin prej tyre kur debatua dhe e këshillua, nuk e dinte se therja e kurbanit për varret është shirk për Allahun – e Madhëruar e

të Lavdëruar. Një person që nuk dallon Teuhidin nga shirku, a bëhet xhihad nën flamurin e tij?! A bëhet xhihad nën flamurin e atij që nuk e dallon Teuhidin nga shirku, as Sunnetin nga bidati, e as haramin nga hallalli, a ky është xhihad?!

Pastaj, ki kujdes o rob i Allahut! Kjo (lufta në Siri dhe në Irak, sh.p) është komplot botëror Cionist (Çifut), Perëndimor dhe Lindor. Për këtë komplot kanë rënë në ujdi shtetet e qafirave, të cilët janë pajtuar që t'i furnizojnë ata fshehurazi, ndërsa nga ana tjetër shfaqin armiqësi ndaj atyre me aq sa duket. Kurse ata janë që i inkurajojnë, sepse e dijnë se kështu i përçajnë Muslimanët dhe i dobësojnë.

Andaj, kini kujdes! Kurse Havarixhët që rrinë ulur **(që nuk kapin armët)** të cilët japin fetva duke ndenjor nëpër shtëpitë e tyre, u themi atyre: **“Përse nuk shkoni ju dhe bijtë tuaj (në luftë në Siri dhe Irak)?!”** Kurse ju rrinë nëpër hotelet e shteteve të Gjirit **(Persik)** apo në hotelet e Evropës dhe i nxisni të rinjtë që të bëjnë kryengritje dhe që të luftojnë nën këto flamuj të injorancës. Kurse ju vet po bëni qejfe, u hipni kuajve dhe dëfreheni me to, uleni nëpër kopshte dhe parqe, ju bashkë me fëmijët tuaj ose në hotelet e shteteve të Gjirit ku Allahu ka dhënë begati ose në hotelet e Evropës. Ju u jepni fetva të rinjve tanë që t'i bashkëngjiten krematorit, Allahu ua dhëntë atë që e meritoni.

Ky është kremator – pasha Allahun. Ata janë myftilerë që devijojnë të tjerët. Pejgamberi – sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem – thotë:

“Kam frikë për Umetin tim nga udhëheqësit (dijetarët) që devijojnë të tjerët.”

Po ashtu ai – sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem – thotë:

“Allahu nuk e merr diturinë duke e shkukur atë (nga gjokset e

njerëzve) porse e merr diturinë duke i marr dijetarët (me vdekjen e tyre), derisa të mos mbetet asnjë dijetar, njerëzit marrin për udhëheqës injorantët, kështu i pyesin ata, e ata u japin fetva pa dije duke e humbur veten e tyre dhe duke i humbur edhe të tjerët.”

Kjo është gjendja e atyre që japin fetva në errësirë dhe gjendja e atyre që japin fetva duke u argëtuar nëpër hotele, vila dhe me makina luksoze, ndërsa këta i kanë djegur bijtë tanë në mbeturinat e krematorit nën flamurin e filanit e fistekut. Kini kujdes! Dija merret nga dijetarët edukatorë, lajmëtarë, të qartë – e jo nga të infiltruarit nëpër shpella – por nga dijetarët të cilët i mënjanojnë nga

Libri i Allahut të Lartësuar shtrembërimet e ekstremistëve, falsifikimet e gënjeshtarëve dhe interpretimet e injorantëve.

Kërkoj ndjesë që e zgjata në përgjigjen e kësaj pyetjeje, ngase siç thonë kjo është temë aktuale dhe se bijtë tanë po digjen në ato krematorë për shkak të fetvave të tyre që i devijojnë të tjerët, dhe vetet e tyre, cenesit, mendjelehtët të cilët nuk kujdesen për marrëveshjen dhe farefisën e besimtarëve.

Havarixhët dhe veprat e tyre të pështira që i bëjnë në Siri dhe Irak.

Autor: Shejkh Salih es-Suhejmi

Pyetje: (Pyetësi) thotë: “Allahu ju dhëntë sukses. Kohët e fundit vërehet se Perëndimi ka marr iniciativë me kërcënimet e tij dhe do të ndërhyj në Irak, (pyetësi) thotë se në fillim SHIISH-i (ISIS) vriste dhe kryqëzonte (njerëz). Tani që këta (terroristët e ISIS-it) kanë filluar me të Krishterët duke i vrrarë burrat e tyre dhe duke i robëruar gratë e

tyre, (pyetësi) thotë: ndërhyri Perëndimi?”

Përgjigje: Në rregull! Cili është shkaku?! Ne po pyesim të kundërtën: Kush është ai që ua dha atyre këtë shkas?! A nuk janë Tekfirijunët, të cilët i masakrojnë Muslimanët, përveç kësaj edhe të Krishterët! Ata masakrojnë çdonjërin që i kundërshton ata, i therin si delet. Ata vrasin të voglin, të porsalindurin, plakun, gruan që janë nga Muslimanët.

Pra, kush është ai që u jep arsye pabesimtarëve nga Perëndimi dhe Lindja, gjë që janë mbledhur kundër Muslimanëve për shkak të veprave të tyre (**Havarixhëve**).

“Çdo fatkeqësi që ju godet, ajo është pasojë e veprave tuaja (të këqija) që keni bërë.” (Esh-Shura, 30)

Pra, këta Tekfirijun dhe Havarixh janë po këta që ua kanë mundësuar atyre pabesimtarëve të bëjnë këtë vepër (**të ndërhyjnë në Irak, sh.p**). Madje ata, tani në Sham, bashkëpunojnë me Nusajrit kundër Ehli Sunnetit, si dhe në Irak e në vende tjera. Ata bashkëpunojnë me armiqtë e Sunnetit, siç janë Rafidijtë dhe të tjerët, kurse ata (**ISIS-i**) shfaqen duke pretenduar se janë armiq të tyre (**Rafidijve**).

Por, këta që janë vrarë nga duart e këtyre (**Havarixhëve**) janë më shumë se ata që kanë vrarë Rafidijt në Irak. Që të gjithë kanë një medh’heb të prishur, qofshin Rafidijt, apo Havarixhët, çfarëdo besimi dhe emërtimi qoftë ai.

Padyshim se të gjithë ata janë në devijim dhe të gjithë janë të dalë nga feja.

“Ata nuk respektojnë as farefisën dhe as marrëveshjen e besimtarit.” (Et- Teubeh, 8)

Unë them: kush janë ata që ua kanë mundësuar atyre këtë?! Ua kanë mundësuar atyre ata që japin fetva të devijuara, të cilët i humbën të rinjtë tanë pas këtij iluzioni dhe u kanë dhënë atyre letrën e indulgjencës (faljes së mëkateve) siç janë letrat e të Krishterëve, letrat e priftërinjve, që nëse e shpërthejnë veten e tyre me eksploziv në një vend të caktuar, menjëherë do t’ju vijë atyre hyritë (bukuroshet e xhennetit).

Është për t’u habitur se nuk e dëgjon prej tyre fjalën **“Ngritja e Fjalës së Allahut”** dhe as fjalën **“Fitorja e Fesë”** porse të gjitha këndimet e tyre, ilahijet, këngët dhe brohoritjet e tyre që po i përsërisin, të gjitha këto kufizohen vetëm tek hyritë. Padyshim se hyritë janë prej begative të xhennetit dhe kjo është një e vërtetë që çdo musliman e kërkon atë, porse që të kufizohen gjërat vetëm tek kjo çështje është injorancë.

Njërin prej tyre që e takuam në Komisionin e Këshillimit, unë e pyeta rastësisht: A je i martuar? Më tha: **“Pasha Allahun në mes meje dhe martesës më ndau një çast i vetëm, porse u privova prej saj.”** I thash: pa si ishte, ma thuaj? Më tha: **“pothuajse isha duke u martuar me hyritë (e xhennetit) në vend të hyrive të kësaj bote, porse më privuan kur më arrestuan.”** I thashë: **“Falendero Zotin tënd që të kanë arrestuar, të kanë ndaluar që të jesh vrasës apo i vrarë, agresor apo të kishe mbaruar. Andaj, falendero Allahun – e Madhëruar e të Lavdëruar – i Cili të shpëtoi që mos t’i vrasësh Muslimanët në emër të Xhihadit të rremë, mashtrimit, i cili nuk është Xhihad porse është shkatërrim në fe.”**

Shikoni këta! Dje kishin vrarë përnjëherë 150 persona nga Ehli Sunneti në Irak, ata Havarixh. E të mos e përmendim fare metodën e

urryer me të cilën i vrasin ata. Para disa ditësh kishin vrarë pesë persona. Ma sha Allah! Ata e **“kanë frik Allahun.”** Ua diktojnë atyre shehadetin (**dëshminë La ilahe il- Allah**), pastaj i vrasin. Në rregull! Prej nga erdhët me këtë gjë (**parim**)?! Nëse ia dikton shehadetin dhe ai e thotë shehadetin, madje edhe sipas terminologjisë suaj, përderisa ai e tha shehadetin dhe hyri në Islam, atëherë përse e vret atë?! Përse e vret atë?! Ata thonë: ne duam që ai të vdes në Islam. Ai e thotë shehadetin kurse ata e therin me thikë.

Ata janë egërsira. Madje me aq sa duket – Allahu e di më së miri – se ata drejtohen nga ana e pabesimtarëve, e kuptojnë këtë apo nuk e kuptojnë.

Dje një grua thërriste: **“O shejkhu jonë Bagdadi! Na merr! Fëmijët tanë kanë shkuar! Fëmijët tanë janë nëpër burgje!”** Një grua e cila jeton në begati, jeton me mbulesë (**hixhab**), jeton në një vend ku ka siguri, dhe në një vend të mbulesës, dëshiron t’ju bashkëngjitet atyre budallenjve dhe u thërret atyre përmes faqeve të twitter-it. Ajo do që ta shpëtojnë atë nga një vend Islam që të jetë nën udhëheqjen e tyre që janë të dalë nga feja e Allahut – të Madhëruar e të Lavdëruar.

Kini kujdes! Kini kujdes! Muslimani nuk është dinak, e as që dinaku e mashtron atë. Kthehuni dijetarëve edukatorë, pyesni ata për këto çështje. Hapi sytë o ti vëlla i ri që mos të mashtrohesh!

Pasha Allahun o vëllezër! Sa për këshillë, gjithashtu po ju përmend diçka që më ka rastisur mua. Njëri që u kthye nga vendet e fitneve (**Siri dhe Irak**), një nga ata që Allahu e begatoi me largpamësi, të cilët u zgjuan dhe erdhën në vete, na ka treguar neve një gjë të çuditshme, tha: **“ekziston një bandë që ka tre shefa. Një shef këtu te ne që i rekruton ata, një shef në Sham dhe një shef në**

Turqi. Kjo është bandë.” Ai tregon dhe thotë: **“Më thanë: sa të holla ke me vete?”** – pasi që u dha besën atyre dhe shkoi me ta? Ai tha: e shita makinën për 20.000 rijal (afër 4000 euro). Më thanë: **“në rregull! Këto 5.000 rijal të ngelën ty që t’i shpenzosh për rrugë, kurse 15.000 ia paguan këtu klientit që është këtu brenda, që t’u dërgohen klientëve të tjerë në mënyrë që të të blejmë me këto armatim e të luftosh me to.”**

Ai tregon: “kur mbërrita atje, nuk pashë Xhihad. Pashë njerëz (Muslimanë) që luftojnë njëri-tjetrin. Më thanë mua: shko tek ky vend dhe hidhe veten në erë me eksploziv. Në rregull! Madje edhe në një vend të Sunnetit!” Pra në një vend ku ka njerëz prej Ehli Sunnetit.

Ai tregon: Kur unë polemizoj me ta, më pëshpëriti njëri prej atyre që ishte i paaftë dhe donte të kthehej – që kishte shkuar prej këtu dhe ishte mashtruar nga ata – më tha: **“mos i kundërshto ata se do të vrasin e do të likuidojnë. Nëse ke mundësi të arratisesh dhe të kthehesh në vendin tënd, atëherë bëje. Unë po pres dhe përpiqem.”** Më thotë mua: **“kam dy muaj (që përpiqem të arratisem, sh.p.) porse nuk kam mundur ngase jam kërcënuar që nëse lëviz prej këtu, atëherë fundi im është vrasja.”**

O vëllezër! Këto gjëra po përsëriten, andaj kini kujdes dhe hapni sytë. Paralajmëroni bijtë tuaj nga këto fetva të devijuara të cilat i japin ata të devijuar. Urdhëroni ata që t’u kthehen dijetarëve edukatorë të cilët i largojnë nga Libri i Allahut shtrembërimet e ekstremistëve, pretendimet e gënjeshtarëve dhe interpretimet e injorantëve.

Pjesë e një ligjërate të Shejkh Suhejmit e mbajtur në Xhamin e Medines Profetike, më datë 12 Sheual 1435, që përkon me datë 8 gusht 2014.

Dallimet thelbësore mes ISIS dhe Selefizmit.

Autor: Shejkh ‘Abdul-Latijf el-Kurdi

Filloj me Emrin e Allahut.

Të gjitha lavdet janë për Allahun, lavdërimet dhe paqja qofshin për të Dërguarin e Allahut, si dhe për Familjen e tij, Shokët e tij dhe të gjithë ata që e pasojnë atë.

E më pas:

Vërtet, është bërë më i shpeshtë kohët e fundit akuzimi i Selefizmit kinse ai është i njëjtë me ISIS dhe se vetë ISIS është një pjellë Selefije-Uhabije. Dhe ky akuzim vjen nga tre grupe:

Grupimi i parë: janë armiqtë e Islamit, ata që thurin komplete kundër tij dhe duan t'i përziejnë letrat dhe ta godasin Selefizmin – i cili është Islami i vërtetë – me akuzën kinse nga ai dolën militantët e ISIS, ndërkohë që ata e dinë që janë gënjeshtarë në këtë akuzim që bëjnë.

Grupimi i dytë: janë adhuruesit e varreve në veçanti dhe bidatçijtë në përgjithësi, të cilët dështuan në përballjen e tyre me dëvetin e vërtetë Selefij, prandaj u mbështetën tek përhapje e pështjellimeve dhe shpifjeve.

Grupimi i tretë: janë disa njerëz të rëndomtë, të cilët janë ndikuar nga dy grupimet e para.

Me qëllim që të mos ketë fitne, mora përsipër që të sqaroj dallimet thelbësore që janë mes ISIS dhe Selefizmit, që kush jeton, të jetojë në argument të qartë, e kush shkatërrohet, të shkatërrohet në argument të qartë. Dhe suksesi është nga Allahu.

01 – Selefijt nuk i bëjnë qafira (**mosbesimtarë**) udhëheqësit e Muslimanëve, edhe nëse ata bëjnë zullume e gjynahe, për sa kohë që nuk shfaqin kufër të qartë. Dhe mosbërja tekfir mbi ta nuk do të thotë që Selefijt besojnë se çdo gjë që bëjnë udhëheqësit është e saktë dhe se çdo urdhër dhe vendim i tyre është i drejtë në peshoren e Sheriatit. Përkundrazi, ne themi se ka gjëra qëpranohen

dhe ka gjëra që u hidhen poshtë. Kurse ISIS i bëjnë qafira udhëheqësit dhe besojnë se ata janë më të këqij se ata që janë qafira në origjinë.

02 – Selefijt besojnë se është obligim bindja ndaj udhëheqësve, përveç në gjërat që janë mosbindje ndaj Allahut. Mirëpo mosbindja ndaj tyre në gjërat që janë mosbindje ndaj Allahut nuk e bën të lejuar kryengritjen ndaj tyre, porse është detyrë që ata të këshillohen sa të jetë e mundur, me urtësi dhe edukatë. **Kurse ISIS në parim nuk i konsiderojnë ata si udhëheqës dhe as nuk besojnë në obligueshmërinë e bindjes ndaj tyre, porse besojnë që ata janë taguta dhe e bëjnë obligim kryengritjen ndaj tyre.**

03 – Selefijt besojnë se gjaku i udhëheqësve është i paprekshëm. **Kurse ISIS besojnë se derdhja e gjakut të të gjithë udhëheqësve është hallall.**

04 – Selefijt nuk bëjnë tekfir mbi policinë, mbi ushtrinë dhe mbi forcat e sigurimit në vendet Islame, si dhe besojnë se gjaku i tyre është i paprekshëm. **Kurse ISIS bëjnë tekfir mbi policinë, mbi ushtrinë dhe mbi forcat e sigurimit, si dhe besojnë se derdhja e gjakut të tyre është hallall.**

05 – Selefijt besojnë se shtetet Islame sot janë toka Islame. **Kurse ISIS besojnë se të gjitha këto shtete janë toka të kufrit.**

06 – Selefijt besojnë se lufta që po bëjnë ekstremistët në këto vende është shkatërrim dhe nuk është xhihad sheriatik. **Kurse ISIS besojnë se lufta që po bëjnë ata kundër qeverive Muslimane dhe popujve Muslimanë është xhihad.**

07 – Selefijt besojnë se është prej Sunetit që të lutesh për udhëheqësit që të keni mirësi, rregullim, drejtim dhe sukses në gjykimin me Sheriatin e Allahut. **Kurse ISIS e bëjnë obligim që të**

lutesh kundër tyre e jo në të mirë të tyre, si dhe besojnë se udhëheqësit janë qafira, prandaj si mund të bëhet duanë të mirë të qafirave, që ata të kenë sukses punimin me Sheriatin e Allahut?!

08 – Selefijt nuk derdhin mundin e tyre në grushte shteti, në revolucione e demonstrata, sepse qëllimi i tyre është nxjerrja e njerëzve nga errësira për në dritë, nga adhurimi i robërve për në adhurimin e Zotit të robërve, nga zullumi i feve të tjera për në drejtësinë e Islamit. Dhe këtë e bëjnë nëpërmjet këshillimit të sundimtarit dhe të sunduarve, si dhe duke thirrur tek Allahu me urtësi dhe këshillim të mirë dhe duke debatuar në mënyrën më të dobishme. E nuk është qëllimi i Selefijunëve që të marrin votat e njerëzve dhe të arrijnë karriget e pushtetit. **Kurse ISIS besojnë se duhet të derdhin mundin e tyre në grushte shteti, në ndërrimin e qeverive nëpërmjet demonstratave dhe revolucioneve është obligim sheriatik, kurse ajo që bëjnë Selefijunët, si thirrja në Teuhid dhe Sunet dhe ruajtja e sigurisë së vendit, kjo sipas tyre është irrxha, tradhëti dhe ata janë shërbëtorë të sulltanëve.**

09 – Selefijt besojnë se lufta **(në Rrugë të Allahut)** do të mbetet deri në Ditën e Kijametit, mirëpo kjo bëhet kur të plotësohet kushtet dhe kërkesat e saj dhe nuk ka asnjë pengesë. Kërkesa e saj është se kur bëhet fjalë për xhihad mbrojtës dhe xhihad sulmues, për të larguar pengesat nga rruga e thirrjes tek Allahu nëpër botë. Kurse kushtet që duhet të plotësohen janë: fuqia dhe mjaftueshmëria shpirtërore dhe siguria nga ndonjë fitne më e madhe. Kurse pengesat e luftimit janë: dobësia e Muslimanëve dhe mos-përgatitja e tyre nga ana shpirtërore, si dhe shkaktimi i dëmeve më të mëdha nga luftimi ose mos- arrijtja e dobive. **Kurse ISIS pretendojnë se kuptimi i fjalës “Luftimi do të jetë i vazhdueshëm” është që mos i japësh luftës peshën që i takon.**

Kështu që, nëse ata nuk gjejnë ndonjë qafir që i lufton, atëherë vrasin Muslimanin dhe jo-Muslimanin që jeton në vendet Islame me marrëveshje, madje ajo që po shohim sot është se ata po vrasin njerëzit e Islamit dhe po i lënë idhujtarët.

10 – Selefiyt i urdhërojnë njerëzit që t’i përmbahen bindjes ndaj udhëheqësve të tyre dhe që të mos rebelohen kundër tyre, se xhemati sheriatik është bashkimi i Muslimanëve në Islam, nën udhëheqjen e presidentit Musliman të shtetit dhe se rebelimi kundër këtij bashkimi është tradhëti, devijim dhe injorancë. **Kurse ISIS i urdhërojnë njerëzit që t’i përmbahen vetëm bindjes ndaj udhëheqësve të ISIS, si dhe të rebelohen kundër udhëheqësve të shteteve Islame, sepse xhemati sipas tyre është vetëm xhemati i tyre, andaj kush del nga xhemati i tyre, bëhet hallall derdhja e gjakut të tij.**

11 – Selefiyt e bëjnë haram vrasjen e atyre jo-Muslimanëve që futen në shtetet Islame me marrëveshje dhe garanci. **Kurse ISIS e bëjnë hallall gjakun e tyre dhe e bëjnë obligim vrasjen e tyre.**

12 – Selefiyt besojnë se ligjet e nxjerra nga njerëzit janë dy llojesh: janë ato që e kundërshtojnë ligjin e Allahut, të cilat janë të refuzuara dhe janë kufër, kurse ai që i ka nxjerr dhe gjykon me to mund të jetë qafir ose mund të jetë zullumqar ose fasik (**i pabindur ndaj Allahut**); ose janë ato që nuk e kundërshtojnë ligjin e Allahut, siç janë ligjet administrative, të cilat i shërbejnë robërve dhe vendit, dhe ky lloj i ligjeve nuk është fare prej Xhahilijetit dhe kufrit, madje duhet t’u përmbahesh këtyre ligjeve – dhe Allahu e di më së miri–

. Kurse ISIS besojnë se të gjitha ligjet e nxjerra nga njerëzit janë prej Xhahilijetit, janë devijim dhe kufër i madh, dhe se kush gjykon me to bëhet qafir me kufër të madh.

13 – Selefiyt besojnë se patja e lidhjeve për çështje të dynjasë mes shteteve Muslimane dhe shteteve qafire nuk është haram, për sa kohë që kjo lidhje nuk përmban marrëveshje që bien ndesh me Sheriatin, si dhe besojnë se përkrahja dhe ndihmimi i idhujtarëve kundër Islamit dhe Muslimanëve është kufër.

Kurse ISIS e bëjnë haram çdo lloj lidhjeje midis Muslimanëve dhe qafirave dhe gjykojnë se kjo është prej ndihmimit të idhujtarëve dhe se kjo lidhje është kufër.

14 – Selefiyt besojnë se është e lejuar mirësjellja ndaj qafirit që nuk

të lufton për fenë tënde dhe as të bën padrejtësi në çështjet e tua të dynjasë, bazuar në Fjalën e Allahut të Lartësuar:

“Allahu nuk ju ndalon të silleni mirë dhe të jeni të drejtë ndaj atyre që nuk luftojnë kundër jush për shkak të fesë dhe që nuk ju dëbojnë prej shtëpive tuaja. Me të vërtetë, Allahu i do të drejtët.” [el-Mumtehineh, 8]

Kurse ISIS besojnë se nuk lejohet mirësjellja me çdo lloj qafiri dhe nuk mbahet drejtësi me ta.

15 – Selefijt besojnë se parimi: **“Kush nuk e deklaron qafir qafirin ose dyshon në kufrin e tij, edhe ai është qafir”**, zbatohet mbi ata që janë qafira në origjinë dhe mbi murrte-dët, ata të cilët i ka shpallur qafira Allahu dhe i Dërguari i Tij, kurse ata Muslimanë që bien në ndonjë prej gjynaheve ose në ndonjë formë të kufrit nuk shpallet qafir dhe po ashtu ai që nuk e bën qafir atë nuk shpallet qafir. Gjithashtu ky parim nuk zbatohet mbi atë që nuk bën qafir atë që e kanë shpallur qafir Khaurixhët ekstremistë padrejtësisht. **Kurse ISIS besojnë se çdokush që nuk e bën qafir atë që ata e kanë bërë qafir, edhe ai vet ka bërë kufër, në të njëjtën mënyrë.**

16 – Selefijt nuk e bëjnë qafir Muslimanin që i bën qafira ata, porse bëjnë qafir vetëm atë që e ka bërë Allahu dhe i Dërguari i Tij – sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem – dhe nuk e refuzojnë gabimin me gabim, as tekfirin me tekfir, porse e refuzojnë bidatin me Sunet, gabimin me atë që është e saktë, padrejtësinë me drejtësi dhe gjynahun me atë që është bindje ndaj Allahut. Pra, Selefijt i frikësohen Allahut për atë (person) që nuk iu frikësua Allahut kur i bëri zullum atyre. **Kurse ISIS i bëjnë qafira Selefijt dhe besojnë se ata janë murrte-dinë (kanë dalë nga Islami) dhe i kërcënojnë me prerje koke.**

17 – Selefijt janë sebeb i rendit dhe i sigurisë; ata i qetësojnë njerëzit që janë të ndezur nga entuziazmi dhe emocionet dhe u mësojnë atyre se si t'i shërbejnë Islamit dhe si ta ndihmojnë atë. Këto ata i bëjnë në përputhje me metodologjinë e Pejgamberëve. **Kurse ISIS janë sebeb i kaosit dhe fitneve; ata i nxisin të rinjtë mendjelehtë e të vegjël në moshë si të bëjnë gjakderdhje, i mësojnë si t'i nxjerrin**

Muslimanët nga Islami dhe si t'i therin sipas metodologjisë së Havarixhëve.

18 – Selefijt drejtohen nga dijetarët edukatorë, të rrënjosur në dije e të mirënjohur. **Kurse ISIS drejtohen nga injorantët.**

19 – Selefijt janë mëshirë e udhëzues për njerëzimin. Ata janë njerëzit më të ditur rreth hakut dhe më të mëshirshmit për njerëzimin. **Kurse ISIS kanë ardhur për t'i therur Muslimanët dhe janë njerëzit më të ashpërkundër tyre.**

20 – Selefijt u kanë bërë dobi Muslimanëve, e kanë nxjerrë në pah bukurinë e Islamit dhe e kanë bërë atë të dashur për zemrat e njerëzve. **Kurse ISIS e kanë shëmtuar namin e mirë të Muslimanëve dhe e kanë bërë Islamin që ta urrejnë zemrat e njerëzve.**

21 – Selefijt besojnë se jo çdokush që bie në kufër bëhet qafir. **Kurse ISIS besojnë se çdokush që bie në kufër bëhet qafir.**

22 – Selefijt janë njerëzit që qëndrojnë më së shumti larg ekstremizmit dhe tekfirit. **Kurse ISIS janë nga ekstremistët e tekfirit.**

23 – Thirrja e Selefijve qëndron më larg se çdo thirrje tjetër nga ekstremizmi, sepse metodologjia e saj bazohet në tekstet e Shpalljes, të cilat kanë ardhur me rrugën e mesme dhe pikërisht kjo është metodologjia e Sahabëve – radij-Allahu ‘anhum – dhe e atyre që i pasojnë ata me mirësi, deri në Ditën e Llogarisë.

Kurse thirrja e ISIS është ajo që qëndron më pranë ekstremizmit, sepse metodologjia e tyre bazohet tek pararendësit e tyre, Havarixhët e hershëm, si dhe bazohet në librat e ekstremistëve bashkëkohorë, siç janë librat e Sejjid Kutbit dhe Meududit.

24 – Thirrja e Selefijve është përmirësim për sunduesin dhe të sunduarit, në aspektin e fesë dhe të dynjasë. **Kurse ISIS as Islamin nuk e ndihmuan, as armikun nuk e thyen, as fenë nuk e zbatuan dhe as dynjanë nuk e rregulluan.**

25 – Thirrja e Selefijve është rruga e vetme që i jep lavdi

Muslimanëve dhe i poshtëron armiqtë e tyre, qafirat dhe mushrikët, por që të bëhet me urtësidhe dije. **Kurse thirrja e ISIS është ajo që më së shumti i poshtëron Muslimanët dhe u jep lavdi armiqve të tyre, mushrikëve dhe ateistëve, si dhe i tërheq ata drejt vendeve Muslimane që t'i pushtojnë.**

26 – Selefijt e ndajnë Teuhidit në tre kategori: Rububijeh, Uluhiyeh dhe el- Esmaa ues-Sifat. **Kurse gjëja më e rëndësishme në Teuhid sipas ISIS është ai që ka shpikur zotëria i tyre, Sejjid Kutbi, që e quajti “Teuhid el- Hakimijeh”, nëpërmjet të cilit bëjnë tekfir mbi të gjithë udhëheqësit e Muslimanëve.**

27 – Qëllimi i Selefijve është që t'u mësojnë njerëzve kush është Zoti i tyre, që ta adhurojnë Atë dhe të largohen nga shirku. **Kurse qëllimi i ISIS është që të nxisë njerëzit kundër udhëheqësve të tyre dhe t'i rekrutojë ata në radhët e tyre kundër udhëheqësve.**

28 – Selefijt i lidhin Muslimanët me Muhaxhirët, me Ensarët dhe me dijetarët edukatorë. **Kurse ISIS i lidhin njerëzit me ideologët tekfiriunë kutbijunë. Edhe nëse pretendojnë se janë pasues të Selefëve (të parët e devotshëm të Muslimanëve), në të vërtetë selefët e tyre janë Havarixhët dhe jo Sahabët dhe dijetarët edukatorë.**

29 – Selefijt largojnë sherrin dhe fitnet nga Muslimanët. **Kurse ISIS e tërheqin sherrin dhe fitnet tek Muslimanët.**

30 – Selefijt thërrasin tek Allahu me dituri të sigurtë dhe me urtësi, prandaj ata janë begati dhe mirësi për Muslimanët. **Kurse ISIS veprojnë me injorancë dhe pa urtësi, prandaj ata janë fatkeqësi dhe sprovë e madhe për Muslimanët.**

31 – Thirrja e Selefijve fillon me dëlirje dhe edukim (et-Tesfijeh uet-Terbijeh): dëlirje të besimit të Muslimanëve nga shirku, nga mohimi dhe deformimi i Cilësive të Allahut, nga përngjasimi dhe barazimi i Cilësive të Allahut me cilësitë e krijesave të Tij, që ata të edukohen me Teuhidin, që ta pastrojnë Allahun nga çdo gjë që i mvishet Atij, që ta madhërojnë, ta lartësojnë dhe t'i nënshtrohen Allahut të Lartësuar, si dhe që ta pasojnë të Dërguarin e Tij – sal- lAllahu 'alejhi ue sel-lem –. **Kurse thirrja e ISIS fillon me hakimije, që të përleshën për pushtet dhe që të vrasin këdo që del në rrugën e tyre. Ata nuk i kushtojnë rëndësi dëlirjes dhe edukimit të**

Muslimanëve.

Shkroi: Ebu ‘Abdil-Hak, Dr. ‘Abdul-Latijf Ibën Ahmed el-Kurdij

Më datë: 28 Dhjetor 2014